

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5596
E hënë, 8 tetor 2018
çmimi 0.40 €

Transformimi i FSK-së në ushtri, në hapat e fundit



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KOALICIONI QEVERISËS PROPOZON DRAFTREZOLUTË PËR UNIFIKIMIN E FAKTORIT
POLITIK RRETH DIALOGUT ME SERBINË

Opozita nuk e përkrah rezolutën e koalicionit qeverisës për dialogun

Përfaqësuesit e partive opozitare, LDK-së, LV-së dhe PSD-së, kanë bërë me dije se nuk do ta përkrahin draftrezolutën për dialog të propozuar nga partnerët e koalicionit qeverisës. Ata kanë thënë të dielën për gazetën "Epoka e re" se propozimet e tilla janë të mangëta dhe kanë për qëllim sjelljen e opozitës para aktit të kryer.

Sipas tyre, ftesat e tilla për unitet janë false dhe jo të mirëfillta. Deputeti i Vetëvendosjes, Ismajl Kurteshi dhe anëtari i Kryesisë së LDK-së, Sali Asllanaj, kanë thënë se nëse pozita dëshiron të ketë front të përbashkët karshi Serbisë, duhet ta ftojë opozitën për të qenë pjesë e hartimit të çfarëdo rezolute apo platforme



FLET PËR "EPOKËN E RE", SAFET GËRHXHALIU

Kosova është në fazën më të vështirë që nga paslufta



Njohësi i proceseve ekonomike, që për dy mandate ishte kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Safet Gërxhaliu, ka thënë se Kosova është para sfidave më të mëdha që nga paslufta. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se në vend se të bëhet progres është duke u bërë regres. Kjo, sipas tij, më së miri mund të shihet me performancën institucionale, ku agjenda politike është

dominante dhe zgjidhja e problemeve ekonomike nuk është temë kyçe. Gërxhaliu ka bërë me dije se kësaj qeverie po i mungon guximi për vendimmarrje. "Sot mungon guximi për vendimmarrje, për të larguar apo dhe ndërruar qasjen e gabuar, sepse çdo gjë është pjesë e koalicionit dhe marrëveshjeve partiake, duke dëmtuar kështu proceset ekonomike", ka thënë Gërxhaliu

Limaj nderon Fehmi e Xhevë Lladrovcin dhe dëshmorët e Marinës



AKTUALE

LIBËR KUJTESE NË
50-VJETORIN E
DALJES SË GAZETËS
SË STUDENTËVE
TË KOSOVËS
'BOTA E RE' F. 11



Nga Faruk TASHOLLI

MË 27 NËNTOR BËHET
RIVARRIMI I HEROIT ILIR
KONUSHEVCI F. 6

IKD-ja: QEVERIA NË MËNYRË
TË KUNDËRLIGJSHME MERR
KOMPETENCA DHE
PËRGJEGJËSI TË KUVENDIT F. 7

EKONOMI

REÇICA KËRKON TË
RESPEKTOHEN MASAT
MBROJTËSE TË SIGURISË
NË PUNË F. 9

SHTESAT PËR FËMIJË, NË
NJË TË ARDHME TË AFËRT

F. 9

KULTURË

Intervistë me autorin e librit
"Jetë në rrugëtim", Haki Morina

PAMJA IME E
RRUGËTIMIT
TË KOSOVËS
DREJT LIRISË



F. 6

SPORT

FLAMURTARI MERR PIKË NË
MITROVICË, FERONIKELI
RUAN KRYESIMIN F. 15

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, Viasa, p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Vuçiçi kushtëzon BE-në

BEOGRAD, 7 TETOR - Presidenti serb, Aleksandër Vuçiçi, gjatë një interviste për "Reuters" duket se ka vendosur të kushtëzojë BE-në. Ai tha se do të kërkojë garanci që nëse vendi i tij do të bëhet pjesë e Bashkimit Evropian në vitin 2025, Serbia do të arrijë të

nënshkruajë ndonjë marrëveshje me Kosovën fqinje. "Përpara se ne të nënshkruajmë një marrëveshje me Prishtinën, Serbia duhet të garantohet se do të bëhet një shtet i Bashkimit Evropian në vitin 2025", tha Vuçiçi. Presidenti serbe sqaroi se

Beogradi dhe Prishtina nuk mund të arrijnë në një marrëveshje për shkak të dallimeve të shumta që kanë vendet e tyre në 10 vjetët e fundit. "Ndonjëherë më vjen të qesh kur dëgjoj njerëzit që i thjeshtojnë gjërat aq shumë, sa që madje i kanë

vënë edhe një datë të caktuar nënshkrimit të marrëveshjes. Madje thonë se, edhe tre fshatra do të këmbëhen me tre", theksoi presidenti i Serbisë. Vuçiçi ka shtuar se nëse do të arrijnë ndonjëherë një marrëveshje me Prishtinën,

ajo do të ishte e përgjithshme që do të përfshijë jo vetëm marrëdhëniet midis tyre dhe shqiptarëve në Kosovë, por do të duhej të përfshijë edhe një rezolutë për avancimin drejt BE-së dhe më tej për zhvillimin ekonomik.

Stoltenbergu: Nevojitet një zgjidhje politike për Kosovën

Shefi i Aleancës Veriatlantike, Jens Stoltenberg, ka thënë NATO-ja mbështet fuqishëm dialogun midis Kosovës dhe Serbisë dhe të gjitha përpjekjet që do të çojnë në uljen e tensioneve dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, duke theksuar se nevojitet një zgjidhje politike



BEOGRAD, 7 TETOR - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka thënë se Aleanca Veriatlantike mbështet fuqishëm dialogun midis Kosovës dhe Serbisë dhe të gjitha përpjekjet që do të çojnë në uljen e tensioneve dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, duke theksuar se nevojitet një zgjidhje politike. Në një intervistë për mediet serbe, Stoltenbergu ka thënë se NATO-ja ka marrëdhënie të shkëlqyeshme me Serbinë dhe se respekton vendimin e Beogradit që Serbia të mos i bashkohet

Aleancës Veriatlantike. "Mbështesim fuqishëm dialogun midis Beogradit dhe Prishtinës, dhe të gjitha përpjekjet që do të çojnë në uljen e tensioneve dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Ne kemi nevojë për një zgjidhje politike. Ky është një dialog të cilin me vëmendje e ndjek Bashkimi Evropian, kurse NATO-ja ishte pjesë e nismës që çoi në këtë dialog. Ne vazhdojmë të monitorojmë dhe mbështesim dialogun", tha Stoltenbergu. Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, të dielën ka

arritur në Beograd, ku do të takohet me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiçi, kurse sot (e hënë) do të qëndrojë në një vizitë zyrtare në Republikën e Kroacisë. Kjo është bërë e ditur nga zyra për informim dhe marrëdhënie me jashtë e NATO-s.

Në Kroaci, Stoltenbergu pritet të takohet me presidentin e Kroacisë, Kolinda Grabar-Kitarović, me kryeministrin Andrej Plenković dhe zëvendëskryeministrin dhe ministrin kroat të Mbrojtjes, Damir Krstičević.

Para vizitës së tij në Kroaci, Stoltenbergu ka thënë se për Aleancën, Kroacia është aleate shumë e çmuar, kurse Serbia partnere e rëndësishme. "Kroacia është aleate shumë e çmuar sepse i kontribuon sigurisë sonë

të përbashkët, mbrojtjes sonë kolektive", ka thënë ai, duke përkujtuar se ushtarët kroatë janë të pranishëm në rajonin e Baltikut, kurse marrin pjesë në misionet e NATO-s në Kosovë dhe në Afganistan.

Bugajski: Moska e sheh Shkupin si bastion të ri në Ballkan

UASHINGTON, 7 TETOR - Analisti amerikan Janush Bugajski vlerësoi se Shkupi është bastioni i ri rus në Ballkan dhe se Kremlin llogarit me atë se Maqedonia mund të bëhet Republika Srpska e re. "Nëse bllokohet rruga e Maqedonisë drejt institucioneve perëndimore, tensionet kombëtare do të rriten në gjithë rajonin, ndërsa Kremlin do të investojë energji shtesë që t'i rrezikojë arritjet e brishta demokratike në Ballkanin Perëndimor, ndërsa Bashkimi Evropian dhe NATO-ja do të jenë

gjithnjë e më larg", thotë Bugajski për gazetën "Pobjeda" të Podgoricës. Ai shton se dalja e ulët në referendum e ka sjellë në pikëpyetje marrëveshjen me Greqinë, por edhe derën e hapur nga NATO-ja dhe BE-ja. "Në qoftë se marrëveshja nuk është mbështetur, vendi më shumë i ekspozohet radikalizimit etnik, jostabilitetit rajonal dhe përzjerjes së Moskës. Rrugëdalja e vetme e Zaevit mund të jetë thirrje për zgjedhje të parakohshme në nëntor, edhe pse kjo vetvetiu paraqet propoz-



im të rrezikshëm, duke pasur parasysh se nacionalistët inkurajohen nga bojkoti i referendu-

mit", thotë Bugajski. Analisti i njohur thekson se nëse presidenti serb Aleksandar Vuçiçi

dhe presidenti kosovar Hashim Thaçi kanë arritur marrëveshje për ndryshim të kufijve, disa liderë shqiptarë, si në Kosovë, ashtu edhe në Maqedoni, mund të shohin mundësi për homogjenizim të mëtejshëm etnik, ndërlidhje të territoreve. "Nacionalizmi dhe separatizmi do ta bëjnë vendin shumë të ndjeshëm për ndikimin e Rosisë", vlerëson Bugajski, duke shtuar se Moska te Maqedonia shikon si në një bastion të saj për luftën kundër NATO-s dhe BE-së.

Presidenti Meta nisi turin në Jug të Shqipërisë

TIRANË, 7 TETOR - Presidenti Ilir Meta sapo është kthyer nga vizita zyrtare në ShBA, ku mori pjesë në sesionin e ri në OKB, takoi në pritjen e delegacioneve presidentin Trump dhe më pas pati takim zyrtar me presidentin e Senatit të ShBA-së. Nga e shtuna ai gjendet në

Berat dhe të dielën në Skrapar. Ilir Meta ka postuar në "Facebook" disa fotografi nga vizitat e tij në Berat dhe më pas në fshatin Prishtë të Skraparit. Postimi i Metës në "Facebook": "Ishte kënaqësi të kaloja një mbrëmje të mrekullueshme në Prishtë, këtu ku mikpritja është

e rrallë. Më në fund e mbajta fjalën për ta vizituar Nënë Bajamen, e cila me sakrificë pa fund ka rritur tre fëmijë të mbarë e të edukuar për të cilët është krenare me të drejtë. E falënderoj për mikpritjen dhe bujarinë e pafundme ashtu siç dinë nënat e Skraparit".



Transformimi i FSK-së në ushtri, në hapat e fundit



Udhëheqësit institucionalë, përfaqësuesit e partive politike dhe njohësit e çështjeve të sigurisë presin që transformimi i FSK-së në ushtri të ndodhë këtë vit. Ata kanë deklaruar se ky proces është në hapat e fundit të tij dhe janë në koordinim me ShBA-në dhe NATO-n. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se për këtë proces Kosova është unike në rrafshin politik, institucional dhe qytetar

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 7 TETOR - Udhëheqësit institucionalë dhe përfaqësuesit e partive politike kanë bërë me dije se procesi i transformimit të FSK-së në ushtri është në hapat e fundit. Ata janë shprehur të bindur se ky proces, në koordinim me partnerët ndërkombëtarë, do të përfundojë brenda këtij viti.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, një ditë më parë ka pritur në takim kryesuesin e Komitetit Ushtarak të NATO-s, Stuart Peach, me të cilin ka biseduar për këtë proces. "Theksova edhe një herë se Kosova ka kryer të gjitha përgatitjet e nevojshme, duke përfshirë një fushatë të gjatë dhe gjithëpërfshirëse të informimit dhe ndërgjegjësimit

lidhur me këtë proces. Theksova shumë qartë se Kosova është unike në rrafshin politik, institucional dhe qytetar për këtë angazhim madhor të konsolidimit të shtetit të Kosovës", ka thënë Thaçi, duke shtuar se ky proces është në përfundim. "Tani jemi në hapat e fundit të përfundimit të këtij procesi të transformimit dhe këta hapa do të bëhen në mënyrë graduale, të koordinuar, në mënyrë të plotë me NATO-n, me ShBA-në dhe të gjithë partnerët tanë strategjikë", ka thënë ai.

Edhe kryeministri Ramush Haradinaj me t'u kthyer nga vizita në ShBA ka thënë se ushtria do të bëhet brenda këtij viti. Ai ka bërë me dije se në takimin që ka pasur me sekretarin amerikan të Mbrojtjes, James Mattis, ka marrë bekimin e

ShBA-së për këtë proces. Sipas Haradinajt, ushtria do të krijohet sipas planit strategjik të paraparë dhe ShBA-ja do të ndihmojë në secilën etapë.

Pas miratimit në Qeveri të tri projektligjeve të nevojshme për transformimin e FSK-së, ato janë miratuar edhe në Komisionin Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, ku kanë marrë votën e deputetëve të të gjitha partive, përveç Listës Serbe.

Ish-komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Kadri Kastrati, është shprehur i bindur se FSK-ja do të arrijë të bëhet ushtri me miratimin e këtyre projektligjeve të propozuara në Kuvend. Ai ka deklaruar për gazetën "Epoka e re" se FSK-në në ushtri nuk e bën emri, por ndryshimi i misionit. Sipas Kastratit, ndryshimi i misionit i përcakton kësaj force detyrat ushtarake për mbrojtjen e vendit. "Unë ua heq këtë skepticizëm atyre 100 për qind sepse nuk ka lidhje se çfarë emri do të ketë kjo forcë. E rëndësishme është që kësaj force t'i jepet misioni ushtarak. Po e përsëris, misioni i përcakton detyrat e

forcës dhe ato detyra do të jenë mbrojtja e kufijve të Kosovës, pjesëmarrja në operacione paqeruajtëse dhe operacione humanitare të udhëhequra nga NATO-ja, BE-ja dhe OKB-ja, si dhe përkrahja e autoriteteve civile. Në bazë të këtyre detyrave dalin nevojat se cilat pajisje, cili armatim, cili transport i nevojitet kësaj force për t'i kryer këto detyra ushtarake. Se a do të quhet Forca e Sigurisë, Forcë e Armatosur apo ushtri, kjo nuk është e rëndësishme", është shprehur Kastrati. Ai ka bërë me dije se kjo mënyrë e transformimit nuk do të sjellë ndonjë pengesë as në rrugën e FSK-së drejt anëtarësimit në NATO.

Edhe kryetari i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Haxhi Shala, beson se iniciativa për formimin e ushtrisë me anë të ligjit është bërë në kohën e duhur. "Besoj se kjo iniciativë është bërë në kohën e duhur. Në fakt, deri më tani është vonuar nga Qeveria procedimi i këtyre projektligjeve për miratim në Kuvend. Sido që të jetë, besoj se Qeveria e Kosovës është koordinuar me partnerët ndërkombëtarë rreth këtyre

projektligjeve. Meqë FSK-në nuk po mund ta transformojmë në ushtri me ndryshime kushtetuese, atëherë duhet t'i japim kompetenca me anë të ligjit", ka deklaruar Shala. Ai ka thënë se transformimi i FSK-së është domosdoshmëri e kohës dhe nuk po bëhet për poenë politike dhe elektorale. Sipas Shalës, iniciativa për ushtri duhet të miratohet së shpejti në Kuvendin e Kosovës e jo të kthehet mbrapa siç ka ndodhur në të kaluarën.

Ndërsa deputetja e PDK-së mendon se vetëm ky koalicion qeverisës mund ta bëjë ushtrinë realitet. "Shpresoj të ecim tutje edhe në proceset e tjera. Siç dihet, u dashtë të vijë kjo Qeveri për ta miratuar demarkacionin me Malin e Zi, sepse Qeveria e kaluar nuk mund ta kalonte ani pse kishim shumë numra. Po ashtu, edhe për projektligjet për transformimin e FSK-së kishim pengesa në atë Qeveri, kurse tani me këtë Qeveri transformimi i FSK-së në ushtri po bëhet realitet. Kam thënë edhe në Kuvend, në fund të mandatit të kaluar, se këtij vendi nuk i duhen liderë që nuk kanë guxim të marrin vendime", ka thënë Musliu.

Kryeparlamentari Veseli, vizitë zyrtare në Çeki

Prishtinë, 7 tetor (ER) - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, ka udhëtuar për vizitë zyrtare në Çeki. Gjatë kësaj vizite kreu i Kuvendit do të marrë pjesë në Forumin

2000, i cili mbahet në kryeqytetin çek. Po gjatë qëndrimit në Pragë, kryeparlamentari Veseli do të pritët në një takim të veçantë nga homologu i tij çek, kryetar i

Senatit të Republikës Çeke, Milan Stech.

Në takim të dy homologët do të flasin për marrëdhëniet midis dy vendeve, për mundësitë e thellimit të bashkëpunimit ndërpar-

lamentar si dhe për vazhdimin e mbështetjes së Republikës Çeke për Kosovën në të gjitha fushat. Veseli do të zhvillojë edhe takime të tjera me përfaqësues të ndryshëm të politikës çeke.



Koalicioni qeverisës propozon draftrezolutë për unifikimin e faktorit politik rreth dialogut me Serbinë

Opozita nuk e përkrah rezolutën e



Përfaqësuesit e partive opozitare, LDK-së, LV-së dhe PSD-së, kanë bërë me dije se nuk do ta përkrahin draftrezolutën për dialog të propozuar nga partnerët e koalicionit qeverisës. Ata kanë thënë të dielën për gazetën "Epoka e re" se propozimet e tilla janë të mangëta dhe kanë për qëllim sjelljen e opozitës para aktit të kryer. Sipas tyre, ftesat e tilla për unitet janë false dhe jo të mirëfillta. Deputeti i Vetëvendosjes, Ismajl Kurteshi dhe anëtari i Kryesisë së LDK-së, Sali Asllanaj, kanë thënë se nëse pozita dëshiron të ketë front të përbashkët karshi Serbisë duhet ta ftojë opozitën për të qenë pjesë e hartimit të çfarëdo rezolute apo platforme

**EPOKA
ERE**

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 7 TETOR - Partnerët e koalicionit qeverisës kanë hartuar një propozim rezolutë për procesin e dialogut me Serbinë e cila do t'i propozohet për harmonizim edhe opozitës. Kjo rezolutë e nënshkruar nga kryeparlamentari Kadri Veseli, kryeministri Ramush Haradinaj dhe zëvendëskryeministri Fatmir Limaj ka për qëllim arritjen e konsensusit mes partive politike për dialogun. Sipas kësaj draftrezolute, sovraniteti, territori, kufijtë dhe rendi kushtetues janë të panegociueshëm. Zëvendëskryeministri dhe zëvendëskryetari i PDK-së, Enver Hoxhaj, ka thënë të dielën se rezoluta e propozuar është rezultat i kërkesave të vazhdueshme të të gjitha partive politike parla-

mentare dhe shoqërisë civile për një rol aktiv të Kuvendit të Kosovës në dialogun Kosovë - Serbi. "Ky rol do të formalizohet edhe zyrtarisht duke e votuar të gjitha partitë rezolutën meqë përmban të gjitha elementet: reflekton qëllimet tona në dialogun me Serbinë, përcakton epilogun e këtij procesi, përfshinë vijat e kuqe dhe heq çfarëdo dyshimi për atë çka duam të arrijmë në këtë dialog, si dhe i përcakton temat e panegociueshme. Prandaj sjellja e kundërt konfirmon se nuk ka vullnet politik jo vetëm për ta përmbyllur dialogun, por as për t'i dhënë rol Kuvendit sikurse është përsëritur në vazhdimësi", ka deklaruar Hoxhaj. Edhe zëvendëskryeministri dhe lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka folur rreth draftrezolutës së koalicionit qeveritar,

duke thënë se kjo rezolutë ka për qëllim ta unifikojë faktorin politik në vend sa i përket dialogut me Serbinë. Ai i ka bërë thirrje opozitës ta votojë këtë draft rezolutë. "Janë përsëritur shqetësimet e të gjitha grupeve politike. Kjo projektrezolutë ka për qëllim unifikimin e faktorit politik. Pra, askush nuk ka mandat për të negociuar për territorin e Kosovës", ka thënë Limaj. Ai ka vlerësuar se kjo draft rezolutë është një hap i madh drejt bashkimit të faktorit politik. "Ftoj të gjitha grupet politike që të bashkohemi në parlament", është shprehur Limaj. Ndërsa kryeministri Ramush Haradinaj ka theksuar se në pikën një dhe pikën gjashtë të rezolutës së propozuar është definuar qartë se kufijtë e Republikës së Kosovës, shtet i pavarur, sovran, demokratik,

koalicionit qeverisës për dialogun



unik dhe i pandashëm, janë të pacenueshme dhe të panegociueshme. "Dhe se Kuvendi i Republikës së Kosovës, si autoritet suprem, me votat e 2/3 e të gjithë deputetëve, do ta ratifikojë marrëveshjen ligjrisht obligative në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë", ka deklaruar Haradinaj. Kurse zëvendëskryeministri i parë dhe lideri i Aleancës Kosova e Re (AKR), Behgjet Pacolli, ka thënë se me nxjerrjen e rezolutës për dialogun me Serbinë i është hapur rrugë fuqizimit të pozitës dialoguese të Kosovës në funksion të arritjes së marrëveshjes ligjrisht obligative me Serbinë. "Përmbajtja e rezolutës krijon mundësi për një strukturë përfundimtare konsensuale në përbërje të të gjithë spektrit politik shumicë. Rezoluta lartëson frymën kushtetuese dhe vendosmërinë e orientimit tonë perëndimor, strategjik, në partneritet me shtete të fuqishme dhe organizata ndërkombëtare. Është koha të projektojmë energji të re dhe nga debati i brendshëm rreth dialogut, të dalim më të fuqishëm se kurdoherë. Koha po ikën, rezoluta pret aprovim sa më shpejt!", është shprehur Pacolli.

LDK-ja, LV-ja dhe PSD-ja kundërshtojnë projektrezolutën e pozitës

Pavarësisht prej ftesave të partnerëve të koalicionit qeverisës që partitë opozitare të jenë pjesë e ekipit negociator si dhe ta përkrahin propozimrezolutën e hartuar nga pozita, një gjë e tillë nuk do të ndodhë.

Tri partitë opozitare, LDK-ja, LV-ja dhe PSD-ja, nuk do ta përkrahin propozimrezolutën e pozitës. Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Ismajl Kurteshi, ka thënë të dielën për

gazetën "Epoka e re" se ftesat e tilla për unitet janë false dhe jo të mirëfillta. "Ftesat emocionale të kryeparlamentarit për unitet bëhen të vërteta kur pozita e fton opozitën para se të hartojë ndonjë dokument në mënyrë që të ulen bashkë dhe të hartojnë qoftë rezolutë, qoftë platformë apo çfarëdo qoftë. Por, ftesa që të aprovohej dokumente që i prodhon pozita për unitet janë false, nuk janë ftesa të mirëfillta. Nëse vërtet duan të kemi një front të përbashkët karshi Serbisë në këto momente shumë të rëndësishme për vendin, duhet të ftohet opozita për të qenë pjesë e hartimit të çfarëdo qoftë dokumenti ose të përcaktimit të Kuvendit pozitë-opozitë për një delegacion dhe për një kryesues të delegacionit. Kjo do të ishte mënyra për ta bashkuar pozitën dhe opozitën karshi Serbisë në këtë situatë", ka deklaruar Kurteshi. Sipas tij, veprimet e fundit janë përpjekje për ta sjellë opozitën para një akti të kryer. "Pozita duhet t'ia dijë hallin vetes sepse nuk i ka votat për këtë punë. Prandaj duhet të silltet bazuar në raportin e forcës brenda Kuvendit, por edhe të punojë për të mirën e vendit karshi Serbisë. Le të mos përpiqet ta sjellë opozitën para aktit të kryer, sepse nuk i ka votat. Po t'i kishte do ta bënte një gjë të tillë pa e lutur opozitën", është shprehur ai, duke shtuar se hartimi i këtyre rezolutave "është hajgare pa krip".

Kurteshi ka thënë se në formën se si është bërë nuk do të përkrahët nga Vetëvendosja ky propozim. "Unë nuk thashë as që do ta përkrahim e as që nuk do ta përkrahim sepse nuk jam ai që marr vendim dhe nuk ka ndonjë vendim brenda Vetëvendosjes për këtë punë. Forma se si është bërë ky propozim është i papranueshëm për ne sepse po tentohet që opozita të qitet para

aktit të kryer", ka theksuar Kurteshi.

Edhe anëtari i Kryesisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Sali Asllanaj, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se kjo parti nuk do ta mbështesë propozimrezolutën e koalicionit qeverisës për procesin e dialogut. Sipas tij, LDK-ja nuk do të përkrahë asnjë veprim të pozitës përderisa nuk miratohet rezoluta e propozuar nga kjo parti. "Ju e dini qëndrimin e LDK-së. Pa u aprovuar rezoluta e propozuar nga LDK-ja nuk do të marrim pjesë dhe nuk do të përkrahim asgjë. Pozita ka bllokuar aprovimin e rezolutës kundër ndryshimit të kufijve. Ndonëse nuk jemi takuar gjatë fundjavës, pra pas këtij propozimi të koalicionit qeverisës, por nuk besoj se do ta mbështesim këtë rezolutë", ka theksuar Asllanaj.

Edhe zëdhënësjë e Partisë Socialdemokrate (PSD), Natyra Kuçi, ka bërë me dije se kjo parti nuk e përkrah propozimrezolutën për dialog të iniciuar nga koalicioni qeverisës. Sipas PSD-së, ky propozim është i mangët dhe nuk dallon nga qëndrimi i mëhershëm i qeverisë për dialogun. "Propozim-rezoluta e djeshme e Qeverisë nuk dallon fare nga qëndrimi i mëhershëm i saj rreth dialogut. Kjo është për keqardhje. Rrjedhimisht, nuk e mbështesim. Tash e sa kohë, Partia Socialdemokrate përpiqet të ofrojë rrugëdalje nga paraliza politike karshi procesit të dialogut. Për këtë arsye e ka deponuar propozim-rezolutën e vet dy muaj më herët. Rezoluta e PSD është më funksionale, më gjithëpërfshirëse dhe përqendrohet në procesin demokratik të ndërtimit të Platformës Negociatore, të përzgjedhjes së ekipit negociator dhe të mbikëqyrjes parlamentare të mbarë procesit", ka shkruar Kuçi në llogarinë "Facebook".

Limaj nderon Fehmi e Xhevë Lladrovcin dhe dëshmorët e Marinës

Drenas, 7 tetor (ER) - Zëvendëskryeministri dhe kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka bërë homazhe të dielën para shtatores së dëshmorëve të kombit, Fehmi e Xhevë Lladrovci, në Drenas dhe në Kompleksin e Dëshmorëve të Kombit në Marinë të Skenderajt.

I shoqëruar nga ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Isa Xhemajlaj, zëvendësministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Çerkin Dukolli, dhe përfaqësues të degëve të Nismës në Drenas dhe Skenderajt, Limaj është ndalur fillimisht në Drenas. Me këtë rast, Limaj ka thënë se sheshi i Drenasit që nga vendosja e shtatores është më i bukur dhe këtij sheshi ka thënë se i takon t'i ketë këta dy njerëz. "Kemi ardhur t'i nderojmë heronjtë e kombit, Fehmi dhe Xhevë Lladrovci. Besoj se sheshi i Drenasit nga momenti i vendosjes së dy shtatoreve është shumë më i mirë dhe më i bukur dhe i

shkon këtij sheshi t'i ketë këta dy njerëz. Një simbol i fuqishëm i lirisë së Kosovës, burrë dhe grua që nuk kursyen asgjë dhe gjatë gjithë jetës së tyre dhe veprimtarisë ushtarake për ta fituar lirinë dhe këtu sot ndriçojnë dhe çojnë mesazhin se kjo liri është arritur falë veprës së sakrificës të dëshmorëve të kombit", ka thënë Limaj të dielën në Drenas.

Pas homazheve në Drenas, Limaj ka vazhduar rrugën për në Marinë të Skenderajt aty ku prehen 158 dëshmorë të kombit. Ai ka thënë se më në fund heronjtë e mëdhenj të luftës së UÇK-së po prehen në mënyrë të dinjitetshme në këtë kompleks. "Sot me krenari erdhëm ta nderojmë veprën e Ilaz Kodrës, Mujë Krasniqit dhe Abedin Rexhës e të qindra luftëtarëve të cilët kanë qenë garda e parë e heroizmit dhe luftës çlirimtare dhe këta burra kanë shënuar historinë e lirisë së Kosovës dhe ne sot ndihemi të nderuar që këta heronj të Kosovës pushojnë



në mënyrë të dinjitetshme në këtë kompleks. Qeveria e Republikës së Kosovës më në fund e kreu detyrën e vet për t'ua dhënë mundësinë heronjve të Kosovës të rivar-

rosën këtu dhe për t'ua dhënë mundësinë njerëzve anekënd Kosovës për të ardhur këtu dhe nderuar luftën e tyre", ka thënë Limaj.

Më 27 nëntor bëhet rivarrimi i heroit Ilir Konushevci


PRISHTINË, 7 TETOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, gjatë një takimi që ka zhvilluar me Halil Konushevcin, babanë e heroit të Kosovës, Ilir Konushevci, ka bërë me dije se tashme është vendosur që më 27 nëntor të këtij viti, që përkon me Festën e Flamurit, do të bëhet

rivarrimi i heroit të Kosovës, Ilir Konushevci, dhe të mjekut e bashkëluftëtarit të tij, Hazir Mala, në Varrezat e Dëshmorëve në Prishtinë.

Eshtrat e Ilir Konushevci deri më tani preheshin në varrezat e Tiranës, ndërsa nga nëntori i këtij viti do të jenë në mesin e dësh-

morëve dhe bashkëluftëtarëve të tij në Prishtinë, në një ceremoni që organizohet nën përkujdesjen e kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj.

Ilir Konushevci ishte një prej figurave të shquara dhe një prej prijësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK).



115 nxënës nga Lugina vizitojnë Kosovën

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 7 TETOR - Rreth 115 nxënës të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit kanë vizituar Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz, ku edhe janë njoftuar për historinë e Jasharëve. Ata kanë vizituar edhe Qeverinë e Kosovës, ku janë pritur nga kryeministri Ramush Haradinaj. Nxënësit patën mundësinë të drekojnë në objektin e kryeministrisë, për të vazhduar pastaj në Parkun Arkeologjik në Ulpianë dhe në qytetin e Prizrenit.

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, e ka mbështetur fuqishëm nismën e Koordinatorit Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport, Rexhep Hoti, për organizimin institucional të ekskursionit të nxënësve nga Presheva, Medvegja dhe Bujanoci, duke shprehur gatishmërinë që nisma të tilla të vazhdojnë edhe në të ardhmen. Njëkohësisht, kryeministri Haradinaj ka kërkuar nga nxënësit t'u bëjnë ftesë edhe bashkëmohatarëve të tyre të gjitha kombësive që ta vizitojnë Kosovën bashkërisht. "Bashkëndiej me ju, familjet e juaja, prindërit me të cilët jeta është jo aq e lehtë, për gjendjen



ekonomike, të drejtat njerëzore, por edhe kombëtare, nevojat e përgjithshme të njerëzve tanë aty, njëkohësisht për nxënësit, shkollën, vendbanimet. Rinia shqiptare, autoktone në trojet e veta, me vlera unike dhe paqedashëse, do të ketë të ardhme prosperuese për të cilën është garanci orienti-

mi ynë propperëndimor dhe synimi për paqe dhe mirëkuptim me të gjithë popujt e rajonit", u shpreh Haradinaj.

Organizatori i këtij ekskursioni, Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport, Rexhep Hoti, ka falënderuar kryeministrin Haradinaj që ia mundësoi

ta realizojë premtimin e dhënë gjatë vizitës në Preshevë. "Është nder i veçantë që në Qeverinë e Republikës së Kosovës të presim nxënës të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës, si dhe të bëjnë një vizitë të tillë nëpër disa vende të Republikës së Kosovës. Shumë shpejt do të organizojmë një viz-

itë dyditore në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc, ku edhe do të shpalojmë Programin Nacional për Rininë", ka thënë Hoti, duke shprehur gatishmërinë që herëve të tjera vizita të tilla të bëhen edhe me nxënësit e shkollave fillore të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit.

Deputetja e PDK-së viziton familjen e Mujë Krasniqit dhe Sylejman Selimit

PRISHTINË, 7 TETOR (ER) - Deputetja e Kuvendit të Kosovës nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Blerta Deliu, ka zhvilluar një vizitë në familjen e Mujë Krasniqit dhe Sylejman Selimit. Bashkë me të ishte edhe Kimetja, bashkëshortja e komandantit Ilaz Kodra. "Bashkë me Kimeten, bashkëshorten e komandantit Ilaz Kodra, ishim në vizitë në familjen e Mujë Krasniqit dhe të Sylejman Selimit, ku biseduam gjatë e për shumëçka me nënat e sakrificës, nënën Shehide dhe nënën Nurije. Në ditë të tilla të dhimbjes dhe krenarisë duhet të kujtojmë njerëzit tanë që dhanë gjithçka nga vetja për liri, por edhe ta respektojmë



vullnetin e familjeve të tyre për të punuar për të ardhme më të mirë.

Familja Krasniqi dhe Selimi janë familje meritore për lirinë dhe



pavarësinë e Kosovës!", ka shkruar

në "Facebook", për këtë vizitë në

IKD-ja: Qeveria në mënyrë të kundërligjshme merr kompetenca dhe përgjegjësi të Kuvendit

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka vlerësuar se Qeveria e Kosovës është duke vazhduar ushtrimin e kundërligjshëm të kompetencave dhe përgjegjësi, pasi është duke ushtruar kompetenca dhe përgjegjësi që i takojnë pushtetit legjislativ, Kuvendit të Kosovës

EPOKA
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 7 TETOR - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) përmes një komunikate për media ka bërë me dije të dielën se Qeveria vazhdon trendin e marrjes së vendimeve të kundërligjshme, duke marrë në këtë mënyrë kompetencat dhe përgjegjësitë e një pushteti tjetër, Kuvendit të Kosovës. "Luftimi i korrupsionit në Kosovë vazhdon të mbetet në letër në top-agjendat e institucioneve shtetërore, por praktikisht institucionet e Kosovës nuk e kanë një strategji shtetërore dhe plan të veprimit për luftimin e korrupsionit për arsye se Qeveria ka miratuar strategjinë shtetërore dhe ka urdhëruar zbatimin e saj, në vend se një gjë të tillë ta kalojë për votim në Kuvendin e Kosovës ashtu siç përcaktohet me ligj", është thënë në komunikatën e IKD-së. Më tej thuhet se në përputhje me obligimet ligjore, Agjencia Kundër Korrupsionit kishte dërguar në Qeverinë e Kosovës Strategjinë Shtetërore Kundër Korrupsionit 2018-2022 dhe Planin e Veprimit, të cilat janë miratuar nga Qeveria në mbledhjen e mbajtur më 23 mars 2018 përmes vendimit Nr. 02/37. "Vendimi i Qeverisë lidhur me miratimin e Strategjisë Shtetërore Kundër Korrupsionit 2018-2022 dhe Planit i Veprimit kishte përcaktuar se vendimi



hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, duke obliguar Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe institucionet e tjera kompetente për zbatimin e vendimit", është thënë në këtë komunikatë.

IKD-ja vlerëson se vendimi i Qeverisë bie në kundërshtim me mandatin dhe kompetencat e Qeverisë së Kosovës, duke marrë kompetencat dhe përgjegjësitë që me ligj i takojnë Kuvendit të Kosovës. "Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit në nenin 16 ka përcaktuar se Agjencia, në bashkëpunim me Qeverinë dhe institucionet e tjera qeveritare dhe joqeveritare, harton Strategjinë Kundër Korrupsionit. Agjencia përmes Qeverisë paraqet për miratim Strategjinë Kundër Korrupsionit në Kuvendin e Kosovës, dokumenti i cili përmban politikat kundër korrupsionit që duhet të zbatohen nga institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës, si në nivel qendror, po ashtu edhe në atë lokal". "Qeveria përmes vendimit të kundërligjshëm ka miratuar Strategjinë Shtetërore Kundër Korrupsionit dhe ka urdhëruar zbatimin e saj pa u miratuar nga Kuvendi. Të njëjtin vendim e ka dërguar në Kuvendin e Kosovës.

Ky i fundit, përmes Komisionit për Legjislacion, ka kthyer mbrapshtë vendimin e Qeverisë, duke vlerësuar se Qeveria ka zbatuar kompetenca të Kuvendit dhe ka kërkuar që vendimi të nxirret në përputhje me ligjin në Qeveri dhe më pas të dërgohet për miratim në Kuvendin e Kosovës. Qeveria prej miratimit të këtij vendimi në mars 2018 ende nuk e ka dërguar në Kuvend vendimin e ndryshuar në përputhje me ligjin për Strategjinë Kundër Korrupsionit dhe rrjedhimisht Republika e Kosovës më shumë se gjashtë muaj nuk ka Strategji Shtetërore Kundër Korrupsionit", është theksuar në komunikatën e IKD-së. IKD-ja vlerëson se kjo situatë shkakton dëme të mëdha, duke pasur parasysh faktin se Strategjia Shtetërore Kundër Korrupsionit do të duhej të fillonte së zbatuari në vitin 2018, pas miratimit nga ana e Kuvendit të Kosovës, sipas procedurave të përcaktuara me ligj, ndërsa tani jemi pothuajse në fund të vitit 2018, dhe e njëjta Strategji ende nuk është proceduar në Kuvendin e Kosovës sipas obligimeve ligjore. "Raporti i Progresit për Kosovën i vitit 2018 kishte konstatuar se Strategjia dhe Plani

i Veprimit Kundër Korrupsionit 2018-2022 janë hartuar pas një procesi konsultativ si dhe janë miratuar në mars të vitit 2018. Tutje, thuhet se Qeveria ende ka nevojë të demonstrojë leadership të vërtetë, aftësi për të praktikuar planifikim paraprak, si dhe vullnet për të ndarë resurse adekuate për luftën ndaj korrupsionit. Kredibiliteti i saj do të varet nga resurset e ndara për implementimin e tyre. Duhet themeluar edhe një mekanizëm monitorues për ta vlerësuar rregullisht ndikimin e strategjisë dhe planit të veprimit", është thënë në këtë komunikatë.

Sipas IKD-së, Qeveria e Kosovës, duke mos proceduar këtë strategji sipas kërkesave ligjore në Kuvend, është duke dëshmuar se e njëjta vazhdon ushtrimin e kundërligjshëm të kompetencave dhe përgjegjësi, duke i ushtruar kompetencat dhe përgjegjësi që i takojnë pushtetit legjislativ, Kuvendit të Kosovës, si dhe duke mos marrë për bazë adresimin e konstatimeve dhe kërkesave të Bashkimit Evropian lidhur me parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në Kosovë. "Një qasje e tillë e Qeverisë bie në kundërshtim edhe me vullnetin dhe qëllimin e shprehur nga ana e

Qeverisë përmes miratimit të së njëjtës për të pasur qasje 'zero tolerancë' ndaj korrupsionit dhe për të vazhduar parimet e tjera siç është: Ndërtimi i integritetit, përgjegjësisë dhe transparencës në punën e organeve të administratës publike dhe forcimin e besimit të qytetarëve në institucionet publike; përmirësimi i legjislacionit dhe fuqizimi i kapaciteteve institucionale për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit; dhe ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë në fushën kundërkorrupsionit.

Ndryshe Agjencia Kundër Korrupsionit në mars 2017 kishte marrë vendim për themelimin e grupit teknik punues për zhvillimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit 2018-2022. Në hartimin e kësaj strategjie në grup punues kanë marrë pjesë institucionet përgjegjëse për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit dhe sundimin e ligjit në Kosovë, përfshirë përfaqësues të shoqërisë civile dhe medias, si dhe ish-in zhvilluar konsultime me ekspertë të jashtëm të angazhuar nga partnerët ndërkombëtarë në Kosovë", është thënë në komunikatën e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Shatri: Pagesat për veteranët vazhdojnë derisa të merret vendimi përfundimtar

PRISHTINË, 7 TETOR - Haki Shatri, këshilltar i kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se veteranët e UÇK-së do të vazhdojnë të marrin pensionet deri në një

vendim përfundimtar nga organet e drejtësisë. Ai për "Ekonomia Online" ka thënë se është padrejtësi pezullimi i pagesave përderisa nuk e vërteton drejtësia

të kundërtën. "Buxheti për këtë kategori të njerëzve është i ndarë dhe vazhdon t'u paguhet dhe nuk e rrezikon buxhetin, sepse ajo shumë e mjeteve është e ndarë në

fillim të vitit dhe dihet sa janë të destinuara për këtë kategori. Nëse ndodh për t'u bërë një spastrim i listave në kohën e ardhshme atëherë normalisht se vepohet në

përputhje me këtë dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Financave, Qeveria i bëjnë vendimet dhe veprimet adekuate", ka thënë Shatri.

Flet për "Epokën e re", Safet Gërxhaliu

Kosova është në fazën më të vështirë



Njohësi i proceseve ekonomike, që për dy mandate ishte kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Safet Gërxhaliu, ka thënë se Kosova është para sfidave më të mëdha që nga paslufta. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se në vend se të bëhet progres është duke u bërë regres. Kjo, sipas tij, më së miri mund të shihet me performancën institucionale, ku agjenda politike është dominante dhe zgjidhja e problemeve ekonomike nuk është temë kyçe. Gërxhaliu ka bërë me dije se kësaj qeverie po i mungon guximi për vendimmarrje. "Sot mungon guximi për vendimmarrje, për të larguar apo dhe ndërruar qasjen e gabuar, sepse çdo gjë është çështje e koalicionit dhe marrëveshjeve partiake, duke dëmtuar kështu proceset ekonomike", ka thënë Gërxhaliu

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 7 TETOR -

"Epoka e re": Z. Gërxhaliu, nga këndvështrimi juaj, në çfarë situatë ekonomike gjendet Kosova?

Gërxhaliu: Nëse bëjmë një analizë të thuktë të aktualiteteve ekonomike dhe politike të cilat janë të ndërlydhura, Kosova është para sfidave më të mëdha që nga paslufta. Në vend se të shënohet përparim, është duke u bërë regres. Këtë më së miri mund ta shihni me performancën institucionale, ku

agjenda politike është dominante dhe se zgjidhja e problemeve ekonomike nuk është temë kyçe, por kemi vetëm humbje kohe. Çështje tjetër mjaft delikate është se kemi shpenzime të pakontrolluara, kemi rënie të investimeve të huaja. Nëse analizohet diskursi politik që është duke dominuar kohët e fundit sa i përket dialogut dhe dukurive që janë duke ndodhur në Ballkanin Perëndimor, me të vërtetë është situatë alarmante që do t'i kushtojë Kosovës në aspektin ekonomik, atë të perspektivës evropiane. Mbi të gjitha, është

duke dëmtuar imazhin, njëkohësisht duke e bërë Kosovën një shtet kur të rinjtë dëshirojnë ikjen. Ikja e kuadrove është shqetësimi më i madh dhe nëse na largohen kuadrot, Kosova kanoset nga një problem i madh saqë për sektorin privat s'do të jetë më sfidues norma e lartë e kamatave dhe energjia elektrike, por mungesa e profesionistëve.

"Epoka e re": Ju përmendet ikjen e kuadrove, çfarë pritet keni rreth liberalizimit të vizave?

Gërxhaliu: Në rend të parë procesi i liberalizimit nuk është

shkop magjik që do t'i zgjidhë problemet e grumbulluara me vite në Kosovë dhe këtë, proces nëse jo në qershor, atëherë pritet ta kemi liberalizimin në fund të vitit të ardhshëm dhe natyrisht se do të jetë mundësi e mirë për sektorin privat, por në anën tjetër ikja e kuadrove do të jetë sfiduese, pasi edhe qytetarët që kanë punë dhe qëndrueshmëri sociale janë lodhur nga ambienti i të jetuarit në Kosovë. Është vërtet shqetësuese që askush nuk merret me aspektin e migrimit dhe që të gjenden forma direkte, indirekte apo periferike që ta ndalim një gjë të tillë që na kanoset, por tentohet të politizohet çdo proces vetëm për të krijuar mjegulli. Azil në Evropë s'ka kërkuar asnjë fëmijë i politikanëve të Kosovës. Po sfida më e madhe do të jetë ikja e të rinjve që s'kanë përkrahje politike.

"Epoka e re": Si e shihni punën e kësaj Qeverie sa iu përket nevojave të bizneseve dhe qytetarëve?

Gërxhaliu: Vërtet është një qeveri që ka kaluar probleme të shumta nga e kaluara, por vetë fakti se ka vazhduar me vendime të gabuara dhe me një mesazh që ka qenë demotivues dhe dekurajues për masën dhe biznesin tregon se kësaj qeverisje i ka munguar guximi për vendimmarrje. Sot mungon guximi për vendimmarrje, për të larguar apo dhe ndërruar qasjen e gabuar, sepse çdo gjë është çështje e koalicionit dhe marrëveshjeve partiake, duke dëmtuar kështu proceset ekonomike. Kjo është dëshmia më e mirë se në një qeveri ku ka më shumë punësime partiake sesa meritore, për ta zgjeruar listën e votuesve, është indikator më i qartë për rrjedhat ekonomike në vend. Pra në këtë qeverisje dominon politizimi dhe partiokracia dhe është hyrë në një rreth vicioz që nuk është e mundur të dalin. Emëruesi i përbashkët është sundimi i rendit dhe ligjit. Në këtë kontekst e themi dhe le të jetë edhe si mesazh se nuk është e rrugës të

që nga paslufta



falë zhvillimit të "Deutsche Telekom", po ashtu edhe Britania dhe Austria u bazuan në këto tri shtylla. Dhe ndërmarrjet të cilat merren me këto veprimtari janë të një rëndësie të veçantë. Kurse në Kosovë paradoksi është se jo që nuk përfitojmë nga ndërmarrjet publike, por ne duhet mbështetur ato, pasi qeverisja i ka bastarduar me punësime partiake dhe devalvim të vlerave. Mbi të gjitha, përkundër alarmit të shoqërisë civile dhe medieve që duhen rimëkëmbur këto ndërmarrje, një gjë e tillë s'ka ndodhur. Shihni në çfarë gjendje është "Trepça" tani.

"Epoka e re": Kur jemi te sistemi gjyqësor, kemi shumë lëndë që presin në sirtar.

Gërzhaliu: Në Kosovë shumë më tepër humbet kohë për të gjetur arsye për dështim sesa për ta zgjidhur problemin. Derisa e kemi këtë qasje zgjidhja e tyre do të jetë shumë larg dhe për të kamufluar me to, atëherë flitet për fitim në kohë dhe përfitim të grupeve të interesit. Në Kosovë kemi të bëjmë me shumë me burokraci sesa korrupsion dhe këtë po e prolongon vendosja e njerëzve të paditur në pozitat kyçe. Po ashtu, edhe sistemin arsimor prej vitesh e kanë shkatërruar. "Një popull që ka arsim të lartë është lehtë për t'u menaxhuar, por vështirë për t'u okupuar", dhe sot në Kosovë ndodh e kundërta. Sundimi i rendit dhe ligjit është sfida kryesore, pastaj flitet për rimëkëmbje ekonomike, edukim dhe përmirësim të imazhit. Vendet e rajonit janë agresive në këto drejtim, e tek ne sa i përket agjendës ekonomike jemi të pakoordinuar, nuk ka asgjë pos deklaratave mediale.

"Epoka e re": Bazuar në përvojën tuaj si përfaqësues i sektorit privat, në çfarë gjendje e kemi sot këtë sektor?

Gërzhaliu: Sektori privat privohet nga lulëzimi i korrupsionit dhe bizneseve të afërta me pushtetarët. Është koha kur duhet të thirren në ndërgjegjen e të gjithëve, por situatë alarmante kemi tek informaliteti. Sektori privat dhe prodhuesit janë në gjendje sfiduese. Po ashtu, është e vërtetë se Ministria e Financave ka marrë hapa stimulues, por nuk kanë sjellë rezultat. Më tepër kemi lehtësira, në anën tjetër kemi edhe informailitet. Duhet të jemi të vëmendshëm në këtë drejtim dhe çdo ministri duhet ta ketë një barometër matës të efekteve. Dua të besoj se në të ardhmen do të kemi një analizë më të thuktë lidhur me masat që do të merren për sektorin privat.



Reçica kërkon të respektohen masat mbrojtëse të sigurisë në punë

PRISHTINË, 7 TETOR (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka takuar të dielën inspektorët e punës. Ai ka bërë me dije se këtë takim e ka zhvilluar me qëllimin që për t'i mbështetur ata edhe në fundjavë, në shtimin e kryerjes së detyrave, në inspektimin dhe kontrollimin e kushteve dhe masave të sigurisë dhe shëndetit në punë, me theks të veçantë në sektorin e ndërtimitarisë. "Nga Inspektorët e punës kërkoja të jenë këmbëngulës për zbatimin e të gjitha masave të sigurisë dhe shëndetit në

punë, duke zbatuar me përpikëri të gjitha ato masa që parasheh legjislacioni në fuqi që rregullon këtë fushë. Kërkoja të jenë të pakompromis, si dhe në bashkëpunim me kompanitë ta rrisin edhe përgjegjësinë e punëmarrësve dhe të punëdhënësve për ngritjen e vetëdijes në aplikimin dhe respektimin e të gjitha masave të mbrojtjes dhe sigurisë në punë", ka deklaruar ministri Reçica.

Ai ka shtuar se duke pasur parasysh numrin e aksidenteve, të atyre edhe me fatalitet, ka

kërkuar nga Inspektorati i Punës që në ditët në vijim ta rrisë numrin e inspektimeve në vendpunishtet e ndërtimitarisë anekënd Kosovës, veçanërisht në Prishtinë dhe qytetet ku sektori i ndërtimitarisë është më i madh. "Nga inspektorët mësova se vetëm në Prishtinë janë kryer inspektime në 244 kompani të sektorit të ndërtimit. Gjithashtu, Inspektorati i Punës kërkon bashkëpunim më të madh edhe nga institucionet e tjera të implikuara si dhe nga qytetarët, me qëllim të rritjes së vetëdijes", ka thënë Reçica.



Më 10 tetor mbahet protestë për humbjen e jetëve në vendin e punës

PRISHTINË, 7 TETOR (ER) - Me moton "Ndërtesat janë tuajat, jeta është e jona" organizata joqeveritare "Beyond the Wall" do të organizojë një protestë para ndërtesës së Qeverisë së Kosovës. Protesta do të mbahet të mërkurën, më 10 tetor, në orën

11:00. "Helmata me emrin e çdo të vdekuri në vendin e punës do të vendoset në rrethojat e Qeverisë. Secili rast që zbardhet helmata bashkë me emrin e të vdekurit në vendin e punës largohet nga rrethojat e Qeverisë, për çdo të vdekur në vend të punës

shtohet një helmë në rrethojat e Qeverisë. Nëse Qeveria i largon helmata pa u zbardhur rastet, nënkupton që ajo po pajtohet me vdekjet. Dhe ne do gjejmë mënyra të tjera për t'ia rikujtuar gjithmonë", thuhet në njoftimin e organizatës.

flitet çdoherë për krizë ekonomike, pasi kemi shumë më shumë krizë juridike. Mospërmbushja apo moszbatimi i ligjit është duke e sjell Kosovën në këtë situatë dhe sot shumë më lehtë është të jesh pjesë e krimit sesa ta luftosh krimin. Kjo është shuarje e shpresës për të rinjtë. Prandaj, në Kosovë nuk mund të pritët luftimi i krimit nga ata që janë pjesë e krimit dhe pjesë e dosjeve për t'u hetuar. Është shqetësuese se si për hir të interesave partiake po shkelën interesat shtetërore, andaj le të jetë mesazh që Kosova është para partive dhe grupeve të interesit.

"Epoka e re": Sipas jush, cilat janë "infuzionet ekonomike" për të dalë nga kjo gjendje?

Gërzhaliu: Bazuar në analizë ekonomike dhe nëse shohim shtetet më të zhvilluara evropiane që zhvillimin e tyre e kanë të bazuar në tri shtylla: telekom, energjetika dhe mineralet, Gjermania është këtu

Partia Fjala kërkon largim nga puna të profesorit që rrahu nxënësin në Besianë

BESIANË, 7 TETOR (ER) - Partia Fjala ka kërkuar që të largohet nga detyra e tij profesori i cili është raportuar se ka ushtruar dhunë ndaj një nxënësi në Gjimnazin e Besianës. Përmes një reagimi kjo parti konsideron se profesorit në fjalë duhet shqiptuar dënimi i merituar siç e kanë quajtur ata nga drejtorja jofunksionale e përgjurmur e Besianës. "Ne Fjala, dega e Besianës, ndihemi të shqetësuar jashtëzakonisht shumë rreth kësaj dukurie tashmë shpesh të përsëritur në Komunën e Besianës, por rasti i fundit, pa

marrë parasysh shkaqet që kanë sjellë në një moment të tillë, është e papranueshme rrahja e profesorit ndaj nxënësit. Ne kërkojmë nga organet kompetente të merren seriozisht me këtë rast dhe t'i shqiptohet dënimi i merituar, kurse nga Drejtoria jofunksionale e përgjurmur e Besianës kërkojmë që me efekt të menjëhershëm ta largojnë nga puna këtë person dhe të bëhet shembull edhe për shumë të tjerë që kanë sjellje të tilla", është thënë në reagimin e kësaj partie.



Lushtaku: Dega e PDK-së në Skenderaj është përgatitur për zgjedhjet e brendshme

SKENDERAJ, 7 TETOR (ER) - Komisioni Zgjedhor i Degës së PDK-së në Skenderaj ka mbajtur takimin e këtij organi ku ka diskutuar për përgatitjet për zgjedhjet e brendshme në nivel të degës. Lajmin e ka bërë me dije përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", Sami Lushtaku. "Si kryetar i degës dhe kryetar i Komisionit Zgjedhor u shpreha se Dega e PDK-së në Skenderaj është e përgatitur për këtë proces të rëndë-

sishëm për partinë dhe të ardhmen e saj. PDK-ja në Skenderaj do të krijojë mundësi të barabartë për t'u zgjedhur dhe për të zgjedhur, për të gjithë anëtarët e PDK-së dhe qytetarët e Skenderajt", ka thënë kryetari i Degës së PDK-së në Skenderaj, Sami Lushtaku. Ai ka ftuar intelektualë, mjekë, profesorë, të rinj profesionistë, të gjithë qytetarët që konsiderojnë se mund të japin kontribut në të mirë të vendit,

që të bëhen pjesë e procesit zgjedhor duke i siguruar se do të kenë hapësirë të mjaftueshme për të gjithë, që të kontribuojnë për avancimin e politikave dhe programit politik të PDK-së - Dekada e Re. "PDK-ja në Skenderaj gjatë procesit të brendshëm do të mbajë zgjedhje në të gjitha nivelet e organizimit, duke përfshirë kuvendet e nëndegëve, Kuvendin e Degës dhe Kryesinë e Degës", ka thënë Lushtaku.

Kryetari i Skenderajt mbikëqyr punimet e fushës së sportit me bari sintetik

SKENDERAJ, 7 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, së bashku me nënkryetarin Nuredin Lushtaku, kanë mbikëqyrur të dielën punimet në ndërtimin e fushës me bari sintetik, si fushë ndihmëse e Klubit të Futbollit "Drenica", finalizimi i së cilës ka hyrë në fazën përfundimtare. Kryetari Jashari ka thënë se fusha është duke u ndërtuar sipas standardeve ndërkombëtare të FIFA-s. "Komuna e Skenderajt ka përgatitur dy projekte sportive, përkatësisht dy fusha futbollit me bari sintetik. Projektin e parë, që do të realizohet në Runik, ku aktualisht procesi është në fazën e përzgjedhjes së operatorit ekonomik, e ka financuar komuna në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Për shkak të procedurave të ministrisë në fjalë, projekti ka shkuar shumë më ngadalë sesa që ishte parashikuar, megjithatë ky projekt pritet të përfundojë brenda vitit. Ndërkaq projekti i



dytë i fushës me bari sintetik është duke u realizuar në bashkëpunim me Federatën e Futbollit të Kosovës. Skenderaj

po shndërrohet në një vend të zhvilluar në aspektin ekonomik, infrastrukturor, sportiv dhe kulturor", ka thënë Jashari.

Aksidentohen autobusët me maturanët e Gjilanit në Shqipëri

GJILAN, 7 TETOR - Një aksident zinxhir mes autobusëve që transportonin maturanët e Gjilanit ka ndodhur të shtunën në Shqipëri. Aksidenti ka ndodhur në dalje të Tiranës dhe nxënësit po shkonin drejt Shkodrës, në ditën e fundit të ekskursionit.

Në aksident, sipas dëshmisë së nxënësve, janë përfshirë tre autobusë. Dy prej tyre, për shkak të dëmtimeve, kanë mbetur në Shqipëri. Nxënësit që ishin në këta autobusë janë shpërndarë në autobusë të tjerë dhe maturanët janë kthyer në Gjilan.



Libër kujtесе në 50-vjetorin e daljes së gazetës së studentëve të Kosovës 'Bota e re'



Nga Faruk TASHOLLI

Të nderuar miq, kolegë dhe bashkëpunëtorë të dikurshëm. Duke shfletuar disa nga kompletet e gazetës "Bota e re" ndër vite, më erdhi ideja që të bëhet një monografi për këtë gazetë, e cila sprovoi shumë pena të gazetarisë dhe publicistikës në Kosovë. Por kjo ide më shkrepiti shumë vonë dhe për të mos shkruar krejt huq, ndërrova

mendje dhe zgjodha tjetër formë. Përmes biografive të punës në gazetë, me ndihmën e kolegëve, që nga numri i parë ta bëj një përmbledhje kujtimesh ku rrëfimet e tyre do t'i shfaqin kryeredaktorët, redaktorët, gazetarët dhe, pse jo, edhe bashkëpunëtorët e jashtëm. Ta bëja biografinë e gazetës më duhej një punë e madhe dhe për të hulumtuar gjatë në biblioteka, që fizikisht nuk mund ta arrij pasi unë jetoj jashtë Kosovës dhe këtu vij rrallë e rri shkurt. Prandaj zgjodha formën tjetër, të rrëfimeve për gazetën që secili të hedhë dritë me kujtimet dhe me vlerësimet për të. Zgjedhja dhe forma e shkrimeve le të jetë e lirë, por secilin në mënyrën e vet, por unë do t'i parashtrij disa teza sa për

orientim, të cilat do të plotësohen edhe nga ju:
Cilat ishin rrethanat shoqërore dhe politike në kohën kur lindi gazeta?
Cila ishte atmosfera në Kosovë kur ju u inkuadruat në gazetë dhe çka ndikoi që të jeni pjesë e gazetës?
Sa ju dha në planin profesional shtysë gazeta që të vazhdoni deri në fund punën në këtë profesion?
Çka ishte dhe çka mbeti për ju gazeta "Bota e re"?
Cili ishte ndikimi i gazetës në informim, në pasqyrimin e gjendjes shoqërore, kulturore, arsimore dhe intelektuale të kohës dhe fuqia e saj në promovimin e vlerave shkencore dhe të krijimtarisë së përgjithshme kulturore dhe kri-

juese?
Sa e çmoni rolin e gazetës në kohën dhe hapësirën kur punuat ju në të?
A keni për të veçuar ndonjë mbresë të thellë nga puna juaj si gazetarë në këtë gazetë?
Besoj me pak fjalë, e kuptuat qëllimin tim, të cilin mund ta plotësoni me shkrimet tuaja, natyrisht duke shtuar edhe tezat tuaja si qasje që në këtë moment mua nuk më kujtohet ta parashtrij. Çdo shkrim i juaji do të më japë mundësi që ta kanalizoj qasjen time gjatë përgatitjes.
Rendi do të ishte që libri i këtij lloji të botohej sivjet, pikërisht në 50-vjetorin e daljes së "Botës së re", por koha nuk premtonte se edhe mua më erdhi vonë ideja. Por kjo punë shpresoj të bëhet

vitin tjetër, natyrisht me ndihmën e miqve dhe ndonjë miku afarist që unë nuk i kam të paktë. Afatin e fundit dua ta lë deri më 30 nëntor 2018 për dorëzimin e shkrimeve.
Kemi fat se shumica nga ne jemi gjallë dhe besoj kemi çka të themi. Ju lutem që shkrimet të jenë sa më të shkurtra dhe sa më të dendura për shkak të volumit që mund të bëhet në përfshirje. Fotografitë apo diçka tjetër që keni nga ajo kohë të mi dërgoni në e-mail: faruktasholli@hotmail.com, ose në llogarinë time në "Fb" (në inbox).
Çdo vërejtje e juaja dhe sugjerim do të jetë i mirëseardhur për mua dhe për realizimin e këtij libri të përbashkët.

Prishtinë, 5 tetor 2018

Shtesat për fëmijë, në një të ardhme të afërt

PRISHTINË, 7 TETOR - Përfaqësues të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në Kosovë kanë bërë me dije për "Radion Evropa e Lirë" se në një të ardhme të afërt planifikojmë ta instalojmë edhe sistemin e shtesave për fëmijë. Në një përgjigje dërguar përmes postës elektronike, zyrtarë të kësaj ministrie thonë se aktualisht janë në fazën e hartimit të dy koncept-dokumenteve, një që ka të bëjë në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare dhe tjetri për rregullimin e fushës së pensioneve. "Me aprovimin e këtyre dy koncept-dokumenteve do të hartohet legjislacioni përkatës që do t'i përcaktojë kompensimet dhe përfitimet për të gjitha kategoritë dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare. Saktësisht, ne planifikojmë krijimin e një Fondi për Sigurime Sociale, me atë të të cilit në një të ardhme të afërt planifikojmë ta instalojmë edhe sistemin e shtesave për fëmijë", thuhet në përgjigjen dërguar "Radios Evropa e Lirë" nga Zyra për Informim e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Shtesat për fëmijët kanë qenë premtim i vazhdueshëm i partive politike gjatë fushatave zgjedhore. Ish-kryetari i PDK-së, tashmë president i Kosovës, Hashim



Thaçi, pati premtuar 300 euro për çdo fëmijë të sapolindur, premtim ky që nuk është realizuar asnjëherë. Ndërkohë, nismën për shtesat e fëmijëve në Kuvendin e Kosovës e pati iniciuar deputetja e Kuvendit të Kosovës nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Donika Kadaj-Bujupi. Ajo në atë kohë pati deklaruar se është llogar-

itur se do të përfitojnë rreth 500 mijë fëmijë, nga mosha 0 deri në 16 vjeç, me nga 10 deri në 40 euro në muaj, varësisht numrit të fëmijëve. Sipas një llogarie, ishte thënë se vlera e shtesave të fëmijëve mund të arrijë në 3 për qind të buxhetit të përgjithshëm të Kosovës. Buxheti i Kosovës për vitin 2018 është 1.8 miliard euro. Kryetarja e Komisionit

Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, Besa Baftiu, në një prononcim për "Radion Evropa e Lirë" thotë se shtesat e fëmijëve janë të domosdoshme dhe se është biseduar për këtë çështje në një seancë parlamentare. "Në seancën e kaluar kemi pasur debat parlamentar lidhur me këtë çështje, ku prej atij debati do të duhej të dilnin reko-

mandime që do ta kushtëzonin Qeverinë e Kosovës, që në buxhetin e ardhshëm të parashihen edhe shtesat për fëmijë. Si shtet jemi vonuar shumë në këtë drejtim duke pasur parasysh kushtet në të cilat jetojnë familjet në Kosovë dhe duke pasur parasysh se shumë familje kanë numër më të madh të fëmijëve", ka thënë Baftiu.



Putini takohet me Netanyahu

TEL-AVIV, 7 TETOR - Kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, ka thënë se ai do të takohet "së shpejti" me presidentin rus, Vladimir Putin. Ky do të jetë takimi i parë mes dy udhëheqësve, që prej se një avion

ushtarak rus ishte rrëzuar në lindje të Detit Mesdhe muajin e kaluar.

Netanyahu dhe Putini kanë folur në telefon dhe janë pajtuar "që të takohen së shpejti për të vazhduar bashkëpunimin e

rëndësishëm ushtarak", tha kryeministri izraelit, duke mos dhënë më shumë detaje se kur mund të ndodhë ky takim.

Putini dhe Netanyahu kanë folur tri herë në telefon që prej se 15 ushtarakë rusë u vranë, kur

avioni i tyre u rrëzua më 17 shtator.

Rusia fajëson pjesërisht Izraelin për këtë incident, pasi Izraeli në kohën e rrëzimit të avionit, ka kryer sulme ajrore mbi caqet iraniane në Siri.

Pompeo: Përparim në bisedimet mbi çarmatimin bërthamor me Korenë e Veriut

Pak pasi arriti në Korenë e Jugut nga Veriu, sekretari Pompeo postoi një fotografi duke ecur përkrah Kimit, ndërsa shkroi se po shënojmë përparim mbi marrëveshjen e Singaporit

WASHINGTON, 7 TETOR - Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, arriti të dielën në Seoul, pas vizitës në Korenë e Veriut, ku u takua me udhëheqësin e saj, Kim Jong Un.

Udhëheqësi i vendit të izoluar u dëgjua duke i thënë kryediplomatit amerikan: "Jam vërtet i kënaqur me këtë mundësi. Pas takimit të mirë, tani mund të hamë së bashku".

Pak pasi arriti në Korenë e Jugut nga Veriu, sekretari Pompeo postoi një fotografi duke ecur përkrah Kimit, ndërsa shkroi se "po shënojmë përparim mbi marrëveshjen e Singaporit".

Një zyrtar amerikan në delegacionin e sekretarit Pompeo, tha se udhëtimi në Korenë e Veriut "ishte më i mirë sesa herën e kaluar" por duhen përpjekje të tjera.

Zyrtari la të kuptohet se disa përparime u shënuan gjatë vizitës, e cila përfshinte një takim me udhëheqësin e Koresë së Veriut, por shtoi se do të jetë një rrugë e gjatë.

Sekretari Pompeo takohet me

presidentin e Koresë së Jugut, Moon Jae-in dhe ministrin e Jashtëm, Kan Kyung-wha, për t'i informuar ata mbi takimin me Kim Jong Un.

Sekretari Pompeo kishte thënë se qëllimi i vizitës në Korenë e Veriut është "që të sigurohemi se e kuptojmë çfarë duan të arrijnë palët dhe si të përmbushen përkushtimet e bëra në Singapor, ku Kim dhe presidenti Donald Trump zhvilluan takimin e tyre historik në qershor. Ai kishte thënë se donte të përcaktonte një datë për një takim të dytë midis Kimit dhe presidentit Trump. Nuk ishte menjëherë e qartë nëse ky qëllim është arritur.

Sekretari amerikan i Shtetit Mike Pompeo, qëndroi të shtunën në Tokio, ndalesa e parë e turneut të tij tregitor në Azinë Lindore. Pompeo u takua me udhëheqësit e lartë të Japonisë, me të cilët diskutoi mbi marrëdhëniet dypalëshe dhe përpjekjet për çarmatimin bërthamor të Koresë së Veriut.

Pas vizitës në Korenë e Jugut ai

do të qëndrojë edhe në Kinë, vizitë që mund të jetë e tensionuar pasi që ndodhë disa ditë pasi nënpresidenti amerikan, Mike Pence, mbajti një fjalim të ashpër duke akuzuar Kinën për tjerash për ndërhyrje në zgjedhjet amerikane dhe shtim të shkeljes së të drejtave të njeriut.



Vetura hyn në mesin e kalimtarëve, 20 të vdekur në Nju Jork

NJU JORK, 7 TETOR - Policia në shtetin e Nju Jorkut njoftoi të dielën se 20 veta humbën jetën në një aksident trafiku në qytetin e Schoharie, kur një veturë hyri në një hapësirë të mbushur me njerëz.

Vetura, sipas autoriteteve lokale, ka hyrë me shpejtësi të madhe në mesin e kalimtarëve pranë dyqanit të shitjes me pakicë të Apple Barrel Country Store.

Incidenti ka ndodhur të shtunën në mbrëmje rreth 270 kilometra nga qyteti i Nju



Jorkut, raporton AP. Autoritetet të dielën nuk njoftuan emrat e viktimave ose detajet e incidentit.

Hetimi i Komitetit Kombëtar për Siguri të Trafikut është në proces dhe është planifikuar të mbajë një konferencë me gazetarë.

Partia pro ruse fiton zgjedhjet në Letoni

RIGA, 7 TETOR - Një parti miqësore me Rusinë ka fituar shumicën e votave në zgjedhjet parlamentare në Letoni.

Partia Harmonia, që ka mbështetjen e shumicës së minoritetit rusishtfolës në këtë shtet të Baltikut, ka fituar 19,9 për qind të votave në zgjedhjet e 6 tetorit, thuhet në rezultatet përfundimtare.

Autoritetet zgjedhore kanë thënë

të dielën se dy partitë populiste, që mund të jenë partnerë të partisë Harmoni, partia KPV LV dhe Partia e Re Konservatore, kanë fituar 14,1 për qind, respektivisht 13,6 për qind të votave.

Partia Zhvillim, që është pro-BE dhe NATO ka dalë e katërta në zgjedhje, duke fituar 12 për qind të votave, duke lënë pas tre parti që janë momentalisht në koalicionin qeverisës së kryeministrit



Maris Kuciskis.

"Harmonia ka qenë dhe do të jetë partia më e rëndësishme e Letonisë", tha pas shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve,

Vjaceslavs Dombrovskis, kandidati për kryeministër i këtij subjekti.

Dalja në zgjedhje ishte 54,6 për qind ka njoftuar Komisioni i Zgjedhjeve.

Në të kaluarën, partitë e tjera kanë refuzuar që të hyjnë në koalicion qeverisës me Partinë Harmonia. Por, shumë vëzhgues thonë se presin që dy partitë populiste, tani do të tentojnë të

formojnë koalicion me këtë parti që është e afërt me Kremlinin.

Letonia, anëtare e BE-së dhe NATO-s, ndan 270 kilometra kufi me Rusinë. Në këtë shtet jetojnë rusë etnikë, që përbëjnë rreth 25 për qind të popullsisë.

Partitë në Letoni janë munduar që të mbajnë politikanët pro-rusë larg pushtetit, teksa shteti kërkon që t'i forcojë lidhjet me Perëndimin.

Në Bosnjë janë mbajtur zgjedhjet parlamentare

SARAJEVË, 7 TETOR - Qytetarët e Bosnjë e Hercegovinës kanë votuar të dielën në zgjedhjet e përgjithshme, që mund të vënë në postet kryesore nacionalistët pro rus dhe t'i çimentojnë ndarjet etnike në vendin që u përball me luftë brutale 25 vjet më parë.

Votimet shihen edhe si një

sprovë nëse Bosnja do të ecën drejt integriteteve në Bashkimin Evropian dhe në NATO, apo do të mbetet e ngujuar në armiqësitë që pasuan luftën e viteve 1992-1995.

Rreth 3.3 milionë veta kanë pasur të drejtë vote për një varg institucionesh në sistemin e ndërlikuar qeverisës të Bosnjës,

të krijuar me marrëveshjen e paqes që i dha fund luftës, e cila la pas vetes 100 mijë të vrarë dhe miliona të pastrehë.

Vendi përbëhet nga një rajon i drejtuar nga serbët dhe një entitet i ngjashëm myslimano-kroat, të bashkuar në një qeveri qendrore. Votuesit kanë zgjedhur të dielën Presidencën boshnjake prej tre

personash, presidentin serb, parlamentet e dy entiteteve dhe autoritetet kantonale.

Nuk ka pasur ndonjë anketë të besueshme para zgjedhjeve. Fushata u vu nën hijen e retorikës përçarëse dhe akuzave për parregullsi që vetëm sa shtuan tensionet.

Serbët dhe kroatët e Bosnjës duan



të afrohen më shumë me Serbinë dhe Kroacinë fqinje, ndërsa myslimanët duan Bosnjën e bashkuar. Çështja ishte në thelb të luftës së viteve të 90-ta.

DOLI NGA SHTYPI LIBRI I DHJETË I PROF. DR. IUR. EQREM ZENELAJ "GJERGJ KASTRIOTI SKËNDERBEU NË VEPRAT E ARTISTËVE EVROPIANË"



Prishtinë, 2018

Eqrem M. Zenelaj

ALBUM HISTORIK KOMBËTAR
NATIONAL HISTORICAL ALBUM

(ME RASTIN E 550-VJETORIT TË VDEKJES SË HEROIT KOMBËTAR SHQIPTAR)
(ON THE OCCASION OF MARKING THE 550th ANNIVERSARY OF THE DEATH OF THE ALBANIAN NATIONAL HERO)

GJERGJ KASTRIOTI-GIORGIO KASTRIOTA


SKËNDERBEU
SCANDERBEG

(në veprat e artistëve evropianë dhe burime të vjetra arkivore)
(in the works of European artists and old archival sources)

E rrallë

La punën për të bërë fshesa si të dikurshmet

Në pranverë të vitit 2017 la punën si stiliste për një kompani dizajnimi dhe nisi të krijojë fshesa tradicionale për t'i shitur. Erin Rous, përveçse stiliste, ka ndjekur dhe një kurs fshesabërësish në New Hampshire të Amerikës, dhe tani që i prodhon vetë, i shet



nga 80 dollarë një fshesë dore, e deri në 200 dollarë ato me shkop.

FOTO E DITES



Në fotografi shihet një krokodil i bllokuar brenda një gome në një lumë në Indonezi. /AFP/

E jashtëzakonshme

Nis shitja e banesave në pallatin më të hollë në botë

Pallati më i hollë në botë në Nju Jork, me 430 metra lartësi, do të ketë një fasadë prej bronzi dhe tullash të kuqe. Raporti 24:1 lartësi-gjatësi e bën ndërtesën më të hollë në botë. Porositë për apartamente kanë nisur dhe ofrojnë një sërë mundësish luksoze. Ndërtimi ka arritur te



kati i 73-të dhe pritet të përfundojë punimet në vitin 2019.

BARSOLETA E DITËS



- Zemër, a jam unë i pari me të cilin ke fjetur?
- Po, shpirt, ti je i pari, se me të tjerët rri zgjuar gjithë natën!



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

“ALPHA” 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson
Regjia: Albert Hughes

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

“JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN”

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.
Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

“NIGHT SCHOOL”

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.
Regjia: Malcolm D. Lee




Në ora 20:00

“SIBERIA”,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.
Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

“VENOM” 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.
Regjia: Ruben Fleischer
Based on the Marvel Comics



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI

Jo të gjitha objektivat tuaja do të


realizohen sot. Shumë dyshime lidhur me një marrëveshje bërë në çastet e fundit.



DEMI

Sot mund t'i mbroni shumë mirë idetë

tuaja edhe pa e ngritur tonin e zërit. Në shumë raste kjo gjë vetëm do t'ju dëmtonte duke krijuar mosbesim.



BINJAKËT

Do të ketë një harmoni midis gjithë

personave tuaj të afërt sot jo falë inteligjencës suaj që keni ditur se si t'i sheshoni mosmarrëveshjet.



GAFORRJA

Sot do të keni debate me këdo

që del përpara në rrugën tuaj. Jo gjithmonë ata që mendojnë ndryshe nga ju e kanë gabim, mbase po gaboni ju.



LUANI

Një udhëtim i papritur do t'i

ndryshojë të gjitha planet e ditës suaj. Duhet të shtyni për më vonë çdo gjë që kishit menduar të bënit.



IRGJËRËSHA

Sot ju duhet të merreni me finan-

cat që po fillojnë po zvogëlohen shumë kohët e fundit. Filloni të kurseni pak që të ndiheni më të qetë.



PESHORJA

Vazhdoni të jeni të pavendosur në qën-

drimet që merrni. Kjo do të sjellë konfuzion jo vetëm tek ju, por edhe te personat që varen nga ju.



AKREPI

Sot do të merrni një dhuratë që nuk e

prisnit. Çdo gjë e mirë që po ju ndodh është falë sjelljes suaj korrekte me këdo që ju ka lidhur puna.



SHIGJETARI

Keni një takim që mezi po e prisni dhe

po i kushtoni të gjithë vëmendjen. Në sajë të tij varen shumë gjëra në të ardhmen tuaj.



BRICJAPI

Jeni duke ecur në rrugë të ndryshme

me partnerin dhe kjo gjë do t'ju nervozojë shumë sot. Do të shkoni drejt një ftohje që sa vjen po bëhet më e thellë.



UJORI

Do të dëgjoni lajme të bukura nga

miqtë tuaj sot dhe kjo gjë do t'ju kënaqë pa masë. Mbase dhe ju mund të bëheni protagonist duke dhënë një lajm tuajin.




PESHQIT

Nëse ndryshoni ambient e keni të

qartë se ku doni të shkoni. Jeni të dashuruar me detin dhe është vendi juaj ideal për t'u relaksuar.

Rita Ora shënon sukses me "Let me love you"



Suksesi i saj në skenën ndërkombëtare është i padiskutueshëm dhe duket se Rita Ora nuk ka të ndalur. Së fundmi ylli i muzikës pop ka publikuar "Let You Love Me" që ka kryesuar klasifikimet. Hiti i ri bëri që Rita ta

shënonte historinë në top listat angleze. "LYLM" është në vendin e gjashtë dhe klasifikohet si kënga e 13 e këngëtares më e dëgjuar në Top 10. Është hera e parë që një artiste femër arrin këtë sukses duke shënuar historinë.

Louise Redknapp po bëhet gati për albumin e katërt



Këngëtarja Louise Redknapp është duke përfunduar ëndrrën e saj në Los Angeles. Ajo po incizon albumin e katërt atje. Nëpërmjet

disa fotografive të nxjerra, Redknapp duket e lumtur me shoqet. Dreka me mikeshat e saj erdhi pasi ajo bëri shaka se po e urrente karrierën e ndërtauar.



Angelina tronditet kur dëgjon për lidhjet e Brad Pittit

Aktorja e famshme Angelina Jolie duket se po i përjeton arëndë lidhjet e ish-burrit të saj, Brad Pitt. Një burim i afërt me të tregon se ajo nuk dëshiron të dëgjojë asnjë lajm lidhur me romancat e reja të Bradit. 43-

vjeçarja edhe pas dy vjetësh ndarje dhe një betejë të gjatë mbi kujdestarinë e fëmijëve, tronditet kur i vijnë lajme të tilla. Brad Pitti u bë temë e shtypit rozë pasi po raportohet se gjeti dashuri të re me bionden Sat Hari Khalsa.

Kanye West mbyll 'Instagram'-in dhe 'Twitter'-in

Duket sikur Kanye West e mbaroi aventurën me rrjetet sociale. Fansat vërejtën të shtunën pasdite se reperi 41-vjeçar fshiu llogaritë e veta në 'Instagram' dhe 'Twitter' pa asnjë paralajmërim ose njoftim. Kanye mori shumë reagime gjatë javës së kaluar në internet pasi shprehu mbështetje për presidentin amerikan Donald Trump.



Intervistë me autorin e librit "Jetë në rrugëtim", Haki Morina

Pamja ime e rrugëtimit të Kosovës drejt lirisë

Haki Morina ka folur për librin e vet të fundit "Jetë në rrugëtim". Ai ka treguar se nevoja e ndriçimit sa më të madh të historisë sonë, të rrugës deri te liria, ishte shtysa më e rëndësishme që i ka dhënë forcë për ta shkruar këtë libër. Në një bisedë për gazetën "Epoka e re", Morina ka treguar se qëllimi i këtij libri ishte që përmes jetës së tij ta pasqyrojë jetën e qindra e mijëra djemve e vajzave shqiptare që kanë sakrifikuar për lirinë

"Epoka e re"

PRISHTINË, 7 TETOR -

"Epoka e re": Këto ditë keni botuar një libër memoiristik. Ç'ju shtyri ta shkruani?

Morina: Ishin lexuesit motivi kryesor. Pa insistimin e disa lexuesve as që do të botohej ky libër. Natyrisht, edhe ideja ime, për nevojën e ndriçimit sa më të madh të historisë sonë, të rrugës sonë deri te liria, ishte shtysa e dytë e rëndësishme që më dha forcën për të shkruar këtë libër. Kjo tregon se çfarë roli ka lexuesi në krijimtarinë letrare. Tekefundit, pa lexues s'ka as letërsi.

"Epoka e re": Meqë libri juaj "Jetë në rrugëtim", në masë të madhe dominohet nga hetuesia dhe burgu, cili është "krimi" për të cilin jeni hetuar dhe dënuar në bazë të ligjeve të kohës?

Morina: Krimi është shumë i rëndë, tepër monstruoze (haha). Ku kishte krim më të madh për jugosllavët sesa përpjekja për realizimin e të drejtave kombëtare të shqiptarëve të shtypur e

të shfrytëzuar?! Krimet tona ishin krime që duhej të bëheshin ose, më mirë të them, ishin krime që i kërkonte koha, ishin krime, pa të cilat, ëndrra jonë për liri e pavarësi do të ndërpritej.

"Epoka e re": Sa kemi mundur të shohim, libri përmban rrëfime rrënqethëse nga periudha e hetuesisë në UDB dhe qëndrimin tuaj nëpër burgje. Si e keni përjetuar kthimin në atë kohë gjatë shkrimit të librit?

Morina: Kthimi në kohë, aq më tepër kur kjo bëhet pas 37 vjetësh, në radhë të parë është i rëndë intelektualisht për ta kujtuar kronologjikisht atë kohë. Por, kthimi në kohë të rëndë shkakton edhe emocione dhe situata shpirtërore të pazakonshme. Është si ta shohësh një film me elemente trishtuese, por edhe me përpjekje të forta të cilat herë të bëjnë të mërzhitur e herë krenar. Shpeshherë çuditësh me vetveten, ose me personazhin tënd, se si ka mundur të përballohet, në një moshë aq të re, gjithë ai mundim.

"Epoka e re": Ku gjenden tani



dhe dini gjë çfarë bëjnë figurat kryesore të librit: udbashët dhe gjyqtarët shqiptarë, të përmendur në libër me emra, si dhe autori i librit, Haki Morina?

Morina: Nuk jam marrë shumë me jetën e tyre pas çlirimit të atdheut. Kam menduar se shteti është institucioni kompetent që do të merrej me drejtësinë e jo individit. Atë çka di është nga ajo çfarë më kanë thënë të tjerët. Dhe kam dëgjuar që ata janë stabilizuar në jetën e tyre, duke qenë nganjëherë edhe të privilegjuar nga politika jonë e pasluftës. Arsyet pse ka ndodhur kjo janë të shumta, por nuk mendoj se kjo është intervistë për të analizuar këtë çështje shoqërore e politike.

"Epoka e re": Si ia arrini të mbijetonit në mërgim?

Morina: Për mua dhe të tjerët si unë, mërgimi nuk është vendi më i mirë për ta përmyllur jetën. Ne u rritëm dhe u kalitëm në përpjekje për lirinë e vendit, për një jetë më të mirë për popullin, për një të ardhme më të ndritur të atdheut. Dhe, pas realizimit, qoftë edhe të pjesërisht të këtij ideali, nuk është e lehtë të jesh i detyruar të jetosh në një vend tjetër.

Njeriu që ka dhënë shumë për atdhe kurrë s'mund të ndihet i "peshuar" në një vend tjetër, siç mund të ndihet në atdheun e tij. Por janë ca rrethana, të cilat kësaj radhe s'do të ndalem për t'i përshkruar, ato që krijojnë paradokse të tilla, siç ka ndodhur me mua dhe me qindra të

tjerë si unë.

"Epoka e re": E kanë merituar këta udbash dhe gjyqtarë shqiptarë faljen tuaj dhe të ish të burgosurve të tjerë politikë të Kosovës?

Morina: Në një vend demokratik dhe të civilizuar, në raste të tilla, s'ka pse të ekzistojë as falja e as hakmarrja. Në vendin ku jetoj, në Zvicër, asnjëherë nuk i kërkohet viktimës falje për kriminelin. Krimineli përgjigjet para drejtësisë dhe këtu merr fund gjithçka. Asnjë ligj pozitiv, në botën e civilizuar, nuk lejon hakmarrjen. Dhe unë jam për zbatimin në jetë të këtyre ligjeve.

"Epoka e re": Cili është mendimi juaj për mungesën e ligjit të lustracionit në Kosovë?

Morina: Nuk jam njohës i mirë i çështjeve juridike të cilat e rregullojnë këtë problematikë. Por, mund të them se një ligj i tillë nuk ka mundur të zbatohet deri tani, të paktën jo 100 për qind, edhe për shkak të disa rrethanave të veçanta shoqërore, por edhe për shkak të marrëdhënieve armiqësore me Serbinë. Pa marrëveshje me këtë shtet, zor që mund të dalë gjithçka në dritë, sepse dihet që dosjet më të rëndësishme të krimeve duhet të jenë në arkivat e Beogradit. Sidoqoftë, një lloj lustracioni ka mundur dhe mund të bëhet, sepse zyrtarët që kanë punuar në disa institucione, janë emra të njohur dhe se veprimtaria e tyre s'ka qenë e fshehtë, por publike. Për shem-

bull, inspektorët e Sigurimit Shtetëror kanë qenë emra publikë dhe populli i di kush kanë qenë.

"Epoka e re": E keni përfunduar rrëfimin për rrugëtimitin e jetës suaj apo do ta vazhdoni edhe më tutje?

Morina: Si çdo njeri që nuk është ndalur asnjëherë në jetë, në përpjekjet e tij për liri dhe barazi kombëtare e shoqërore, rrëfimi i tij nuk mund të ndalet në një moshë ende pa i mbushur të 30-tat, siç ndalet rrëfimi im në këtë libër. Edhe pse në vazhdimin e përpjekjeve të mia jetësore nuk kam më burg, hetime e tortura, mendoj se nuk është më pak e rëndësishme dhe jointerese sesa pjesa e "parë" e rrëfimit që është pasqyruar në këtë libër.

Mendoj se vazhdimi i shkrimit të plotë të këtij libri, i cili natyrisht duhet të kishte edhe dy pjesë të mëdha, ajo e viteve '90-ta, deri në largimin e Serbisë nga Kosova dhe ajo e pas çlirimit, do të jepte një pamje më të plotë të rrugëtimit tim jetësor. Mendoj se rrugëtimi im është rrugëtimi real i Kosovës, me plot pengesa e vështirësi, me plot sfida e kundërthënie të paparashikuara.

Qëllimi im nuk ishte thjesht ta publikoj jetën time. Qëllimi im ishte që përmes jetës sime ta pasqyroj jetën e qindra e mijëra djemve e vajzave shqiptare që sakrifikuan tërë jetën për lirinë. Pra qëllimi im ishte ta jap një pamje "filmike", sa më origjinale, të rrugëtimit të Kosovës drejt lirisë.



Leksione dashurie nga Frida

Dua të të them diçka? Do doja ti shtrija pafund krahët e mia për të të dashur pa masë... Frida Kahlo artistja e njohur shkruante kështu për dashurinë. Me një jetë plot trazime ajo nuk harroi asnjëherë të dashuronte, duke e parë si shpikjen më të bukur të njerëzimit. Ja cilat ishin motot e jetës së saj.

1.Të duash është të falësh "Kam pasur dy aksidente të mëdha në jetën time: një në autobus dhe Diego. Diego është më i keqi".

Diego Rivera ka qenë dashuria e përjetshme e Fridës, depozitot tek ai të gjitha shpresat e dashurisë pas një jete torturose. Ai e tradhtoi shumë herë Fridën gjatë martesës së tyre. Ajo e fali pas çdo tradhtie, duke pranuar se dashuria i reziston gjithçkaje dhe përfshin të falurit.

2.Dashuria është e pashpjegueshme "...martesa mes Fridës dhe Diegos ishte si bashkimi mes një elefanti dhe një pëllumbi", do të shprehej nëna e Fridës.

Shumë mendonin se Diego dhe Frida nuk kishin shumë të përbashkëta përveç pikurës, por e vërteta ishte se dashuroheshin në një mënyrë të pashpjegueshme. Ai ishte i dhënë pas femrave dhe Frida ishte e dhënë të dinte se me kë shkante. Përveç kësaj, kurrë se lanë njëri-tjetrin. Gjithashtu kishin të njëjtat ideologji politike.

3.Duaj veten "E vetmja gjë që di, është se pikturoj sepse kam nevojë". Ta duash veten do të

thotë që nuk e harron veten dhe çfarë beson. Diego e donte Fridën sipas mënyrës së tij dhe ajo e pranoi pa kushte pa prituri se do ndryshonte. Piktura e ndihmonte të përballonte sëmundjen. Kurrë nuk u dorëzua dhe nuk pushoi së krijuari art.

4.Mos ki turp nga stili yt Frida Kahlo është një ikonë e modës në Meksikë dhe në botë. Stili që e karakterizonte në vitet '30 vazhdon të jetë frymëzim për modën meksikane dhe ndërkombëtare. Shtëpi mode kanë krijuar dizeno të mrekullueshme duke u bazuar te piktoria meksikane. Veshjet e saj plot ngjyra dhe vetullat karakteristike janë kthyer në pikë referencë për kulturën dhe sofistikimin e Meksikës.

5.Mos u lidh me planet e tua "Asgjë nuk është absolute. Gjithçka ndryshon, gjithçka lëviz, gjithçka rrotullohet dhe shkon larg". Frida nuk mendoi kurrë të ishte artiste. Jeta e çoi te arti pas aksidentit që e la për muaj të tërë të bllokuar në krevat. Aty gjeti kënaqësi të lëvizja e duarve. Ajo donte të bëhej mjek.

6.Gratë kanë shumë forcë përbrenda "Në fund të ditës mund të durojmë shumë më tepër nga çfarë mendonim." Frida ishte një grua e fortë që arriti gjëra të rëndësishme. Qoftë vepra ashtu edhe jeta e saj shërbejnë si udhëzues për shumë persona që kërkojnë një identitet dhe e gjënë te arti.

7.Është e shëndetshme të kesh një ditar "Asnjëherë nuk pikturoj ëndrra apo makthe; pikturoj



realitetin tim". Trishtimi është e vetmja ndjenjë që ka një rezultat fatal te njeriu. Të kesh një ditar ku të shkruash apo të vizatosh gjithçka na ndodh, shërben si mjekim për shpirtin. Frida bën pjesë të artistët që e evidentuan jetën e tyre nëpërmjet librave që ruajnë informacion të vyer dhe ku lexohen ndjenjat dhe jo vetëm fjalët.

8.Vuajtja është dituria e maskuar "Pij për të mbytur dhimbjet e mia, por të mallkuarat mësuat të notojnë". Jeta e Frida Kahlos gjithmonë ka qenë e vështirë. Kur

ishte adoleshente pësoi një aksident që e paralizoi gjithë jetën e saj. Jetonte mes shtratit të saj dhe spitaleve, ku kishte kohë të vizatonte gjithçka që i kalonte në mendje dhe emocionet e ngurtësonte përmes autoportretesh.

9.Të dish kur duhet të heqësh dorë "Nuk jam e sëmurë, jam e thyer". Frida Kahlo duroi shumë tradhti të Diegos, dhe i fali. E fundit ishte ajo me motrën e saj të vogël, Cristina. Atëherë ishte dhe kur vendosi se ishte koha ta linte Diegon dhe kur abortoi për herë të tretë. U ndanë për katër vite.

Frida na trego se duhet pasur forcë dhe se kurrë nuk është vonë për të qenë i lumtur.

10.T'i lësh gjërat të shkojnë "Shpresoj që largimi të jetë i gëzueshëm dhe shpresoj mos të kthehem kurrë". Varësitë e vranë Fridën. Alkooli i tepërt dhe anemia e tretën trupin e saj, por kurrë shpirtin e forcës dhe lumturisë. Gjithmonë ishte në krye të festave, në të cilat nuk pushonte së kënduari. E shijoi shumë jetën që vuante. Vetë ajo ishte arsyeja e jetës dhe vdekjes. (gazeta-Shqip.com)

Dashuria e fshehtë e Truman Kapote

Një ndër historitë më të gjata të dashurisë së Truman Kapote është ajo me profesorin e njohur të letërsisë, kritikun Newton Arvin. Në vitin 1951 ai do të fitonte National Book Award me biografjinë e Herman Melville. Disa nga veprat e tij më të rëndësishme Kapote ia ka dedikuar kësaj dashurie. Bashkë ata do të jetonin një nga një pasionet më të mëdha në jetën e shkrimtarit, që nuk e fshehu dot homoseksualizmin.

Për Kapote varësia ndaj Arvin shpesh bëhej e njëjtë me atë ndaj letërsisë. Truman Kapote është një emër i njohur i letërsisë amerikane. I lindur në Lujzian në qytetin e New Orleans dhe u shua në Los Anxhelos në moshën 59-vjecare. Për jetën e tij në vitin 2006, është xhiruar filmi nën titullin e thjeshtë "Capote" për të cilin, aktori Philip Hoffman fitoi Akademi awards për rolin kryesor mashkull. Capote lindi si Truman Streckas Parsons.

Ai ishte një fëmijë i vetmuar, gjë që do të linte ndikim në mënyrën sesi ai e përjetoj jetën më vonë. Nëna e tij kur e lindi i kishte vetëm 16 vjeç. Prindërit e tij do të ndaheshin kur ai ishte 4 vjeç. Truman i vogël shkon në Alabama ku u rrit nga të afërm të nënës.

Të gjithë kalvarin e jetës gjatë fëmijërisë ai e përshkruan në librin "Tregimet e Krishtlindjeve". U bëra njëmbëdhjetë vjeç, dikur më vonë u bëra gjashtëmbëdhjetë vjeç. Edhe pse atëherë nuk ma varte njeri, ato ishin vite të mrekullueshme", shkruan ai.

Në vitin 1933 ai udhëtoi drejt Nju Jorkut për të jetuar me nënën e cila tashmë ishte martuar sërish ku ndërron dhe emrin në Truman Capote Garcia. Romani i tij i parë do të shitej në miliona kopje. Në qendër të librit është udhëtimi i dy të rinjve drejt lumturisë. Ai vdiq më 25 gusht 1984, nga një mbidozë në Los Angeles.

(gazeta-Shqip.com)



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	FC KOLN - DUISBURG	1	XANTHI - LARISA	1	CORK - BOHEMIANS	1
-------------------	--------------------	---	-----------------	---	------------------	---

Flamurtari merr pikë në Mitrovicë, Feronikeli ruan kryesimin

Elita e fundit të Kosovës vazhdon të jetë interesante, kurse skuadra e Feronikelit e mposhti KEK-un për ta vazhduar kryesimin në renditjen tabelore. Skuadra e Flamurtarit vazhdon të jetë skuadër e befasive në futbollin e Kosovës, kurse të dielën luajti baras me Trepçën '89. Të dielën fitores i është gëzuar edhe Liria në përballje me Gjilanin



EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**
PRISHTINË, 7 TETOR - Të dielën janë zhvilluar dy ndeshjet e fundit në kuadër të javës së nëntë në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Gjilani, pas një fazë me rezultate të mira, pësoi humbje papritur në fushën e vet nga Liria me rezultat 0-1. Golin e vetëm që ua solli tri pikëve prizrenasve e shënoi sulmuesi Fatih Karahoda në fund të pjesës së parë. Gjilani i trajnerit Sadat Pajaziti u mundua ta barazojë rezultatit në pjesën e dytë por, pa sukses. Në ndeshjen tjetër të zhvilluar në stadiumin "Riza Lushta", Trepça '89 dhe Flamurtari, përfundoi me rezultat 2-2. Për vendësit të dy golat i shënoi Mircevski, kurse për kuqezinjte e kryeqytetit golashënues ishin Maliqi dhe Shillova. Ndërsa skuadra e Prishtinës pas

disa rezultateve jo të mira në xhirot e fundit ka arritur të këndellet dhe ta fitojë derbin ndaj Flamurtarit me rezultat 2-1. Mysafirët kaluan të parët në epërsi me golin e shënuar nga Behar Maliqi, pas dhjetë minutave lojë, kurse rezultatit e barazoi pas një ore lojë, Basit Khalid. Fitoren Prishtinës ia siguroi Marjo Morina, me golin e shënuar në minutën e 90. Ndërsa skuadra e Feronikelit shënoi fitore pa ndonjë vështirësi në përballje me KEK-un, me shifrat 4-1. Fitores i është gëzuar edhe Drita e Gjilanit që e mposhti Drenicën, 2-1, me golat e shënuar nga Bujar Shabani dhe Xhevdet Shabani, teksa golin e vetëm për drenicasit e ka realizuar Taulant Dajaku nga penalltia. Në anën tjetër, Ferizaj ka arkëtuar tri pikë të mëdha në Suharekë, duke e mundur Ballkanin 1-0.

IPKO Superliga

Trepça '89 - Flamurtari	2-2
Gjilani - Liria	0-1
Feronikeli - KEK-u	4-1
Drenica - Drita	1-2
Ballkani - Ferizaj	0-1
Prishtina - Llapi	2-1

	Tabela	PIKË
1. Feronikeli	9	23
2. Prishtina	9	18
3. Llapi	9	16
4. Flamurtari	9	16
5. Gjilani	9	14
6. Drenica	9	12
7. Trepça '89	9	11
8. Drita	9	10
9. Ferizaj	9	10
10. Liria	9	9
11. Ballkani	9	9
12. KEK-u	9	1

Në xhirot e radhës takohen: KEK-u - Ferizaj, Liria - Trepça '89, Flamurtari - Drenica, Drita - Ballkani, Feronikeli - Prishtina, Llapi - Gjilani.

SHKURT

Feniksi e mbyll pa fitore fazën e dytë të Ligës së Kampionëve

Feniksi e ka mbyllur pa fitore fazën e dytë të Ligës së Kampionëve të Futsallit, e cila njihet si "Main Round". Kampioni i Kosovës është mposhtur të shtunën mbrëma nga Sporting Lisbona me rezultat 0:5, në ndeshjen e zhvilluar në Pallatin e Sportit në Prishtinë, pasi klubi nga Drenasi ishte mikpritës i kësaj faze, të cilën e organizoi në mënyrë të shkëlqyeshme. Feniksi i kishte humbur edhe ndeshjet paraprake nga Kairati të mërkurën mbrëma, 3:7 dhe nga Lida, 2:3, të enjten mbrëma. Me këtë rast, Feniksi nuk arriti të kualifikohet në mesin e 16 më të mirëve të këtij kompeticioni, megjithatë lojtarët e dhanë maksimumin në parket.

Hamiltoni fiton në Japoni, dështon Ferrari

Fitorja e nënte sezonale do ta lejojë britanikun Lewis Hamilton të prezantohet në Austin, në garën e ardhshme të Botërorit të Formula 1, me mundësinë matematike që ta fitojë titullin kampion. Piloti i Mercedesit i la pas të gjithë në pistën e Suzukës dhe ka përfutuar nga dita e keqe e Sebastian Vettelit për të shkuar në +67 pikë në klasifikimin e pilotëve. Gjermani i Ferrarit e nisi mirë garën duke rekuperuar disa pozicione, por në një tentativë parakalimi ndaj Max Verstappen gaboi në frenim dhe pati kontakt me holandezin, duke dëmtuar më shumë veten. Në fund, Velteli përfundoi garën i gjashti, pas shokut të skuadrës, Kimi Raikkonenit. Në podiumin e Suzukës u ngjitën Valtteri Bottas (Mercedes) dhe Max Verstappen (Red Bull).

Kastrioti e Drita shënojnë fitoret e radhës

Kastrioti i Ferizajt dhe Drita e Gjilanit kanë vazhduar me fitore në Superligën e Kosovës në hendboll. Kastrioti fitoi në Ferizaj ndaj Vëllaznimit të Gjakovës me rezultat të lartë, 38:19. Për Kastriotin kjo ishte fitorja e katërt dhe tashmë shkëputet në krye të klasifikimit me tetë pikë. Kastrioti këtë edicion synon të luftojë si për titull të kampionit, po ashtu edhe për Kupë të Kosovës. Drita në Gjilan fitoi ndaj Vushtrrisë me tetë gola dallim, me rezultat 33:25. Fitoren e parë në këtë edicion e ka shënuar Trepça, që fitoi në Vushtrri ndaj Samadrexhës me rezultat 24:18.

Shënojnë Lenjani dhe Kololli

Ermir Lenjani shënoi golin e vetëm të Sionit në transfertë me Xamaxin, duke i siguruar një pikë ekipit të tij ndaj skuadrës që mban vendin e fundit, pasi rezultati përfundimtar u fiksua në 1-1. Për Lenjanin ky ishte goli i parë sezonal në tetë takime në Superligën e Zvicrës. Një tjetër shqiptar geti rrugën e rrjetës në elitën e futbollit zviceran. Bëhet fjalë për Benjamin Kolollin, futbollistin e përfaqësueses së Kosovës, që shënoi dy herë për Zyrhun në transfertë me Thunin, por ekipi vendës arriti të reagoje duke barazuar 2-2.

Grasshoppersi, fitore të rëndësishme në shtëpi, Ajeti bën debutimin si titullar

Ka përfunduar ndeshja midis skuadrës së Grasshoppersit dhe ekipit të Luganos. Ndeshja aq shumë e luftuar nga të dyja skuadrat ka përfunduar me fitoren e vendësve të Grasshoppersit me rezultatit 2-1. Për t'u theksuar në këtë sfidë është edhe prania që nga minuta e parë e lojtarit të Kombëtares Shqiptare, Arlind Ajeti. Mbrojtësi ka bërë debutimin e tij me skuadrën e re dhe e ka nisur si titullar. Duket se debutimi si titullar i Ajetit i ka sjellë fat të mbarë skuadrës së tij në këtë ndeshje të vështirë.

Halep: Jam numri 1, do të jem në finalet e Championshipit

PULAU UJONG, 7 TETOR - Edhe pse nuk është ende në formë, duke u mundur që në raundin e parë në 3 turnetë e fundit ku ka marrë pjesë, madje duke u tërhequr në dy prej tyre për shkak të problemeve fizike, tenistja rumune Simona Halep beson se do të jetë në finalet e Championshipit që

zhvillohen më 21-28 tetor në Singapor. Në këtë turne marrin pjesë tetë tenistet më të mira në botë dhe Halep, që aktualisht është numri 1, shpreson të jetë. "Tani ndihem shumë më mirë. Natyrisht se kam qenë e shqetësuar, por pasi kreuva një rezonancë magnetike kemi kuptuar

problemin dhe si ta parandalojmë atë. Kam pasur disa shqetësime në shpinë në të shkuarën, por tani ato janë zbutur dhe jam gati për t'u rikthyer", u shpreh Halep në një intervistë për mediet e vendit të saj. "Vazhdoj ende të punoj për të rikuperuar 100 %, duke kryer

fizioterapi. Do ta kryej edhe një javë tjetër pushim dhe do ta nis përgatitjen për finalet e Championshipit, duke u stërvitur gradualisht. Rëndësi ka shëndeti, por do të shkoj në finalet e këtij turneu. Nuk ka asnjë shans që të operohem, pasi situata është nën kontroll", ka shtuar Halepi.



Kryeministri i Portugalisë: Ronaldo nuk është fajtor

LISBONË, 7 TETOR - Kryeministri i Portugalisë, Antonio Costa, e ka mbrojtur yllin portugez të Juventusit, Cristiano Ronaldo, pas akuzave ndaj këtij të fundit se e kishte përdhunuar një grua në një hotel të Las Vegasit para nëntë vjetëve. Ronaldo është akuzuar për përdhunim nga Kathryn Mayorga, e cila pretendon se sulmuesi i Juventusit e kishte përdhunuar atë në tualetin e një hoteli në Las Vegas në vitin 2009. Megjithatë, Ronaldo i ka mohuar këto akuzat. Ronaldo u la jashtë skuadrës së Kombëtares së Portugalisë për ndeshjet e tetorit, megjithatë është bërë me dije se kishte qenë vetë portugezi ai i cili e kishte kërkuar një gjë tillë. Ai dëshiron të stërvitet më shumë për Juventusin dhe i duhet pak më shumë pushim. Kur u pyet nga gazetarët për akuzat ndaj Ronaldos gjatë një vizite në Laxarote, kryeministri i Portugalisë, Antonio Costa, u përgjigj duke thënë se Ronaldo e ka dëshmuar se është një profesionist i jashtëzakonshëm, dhe se derisa të përfundojë hetimi, ai duhet të konsiderohet i pafajshëm. "Njerëzit duhet ta kuptojnë se një person është i pafajshëm deri në përfundim të hetimit. Nuk mjafton të akuzohesh për diçka, që të jesh fajtor për të", ka thënë



Costa, duke shtuar: "Dhe nëse ne kemi dëshmi për diçka, është se ai është profesionist i jashtëzakonshëm, sportist i jashtëzakonshëm, futbollist i jashtëzakonshëm dhe dikush që i ka dhënë nder dhe prestigj Portugalisë. Dhe, natyrisht, ne të gjithë urojmë që asgjë të mos e dëmtojë këtë rekord të Ronaldos. Kështu që, për ta gjykuar si të vërtetë diçka që është

vetëm akuzë, më falni, por nuk mjafton vetëm një padi publike, së cilës iu nevojiten caq shumë vite për t'u ndërtuar". Sponsorët e Ronaldos, "Nike" dhe "EA Sports", e kanë shprehur shqetësimin e tyre për këto akuzat, ndërsa Juventusit e ka mbështetur yllin e skuadrës së tij, duke e quajtur portugezin kampion të mrekullueshëm.

McGregori: Nokaut i mirë, mezi pres të luftoj përsëri me Khabibin

LAS VEGAS, 7 TETOR - Conor McGregor ka reaguar ndaj humbjes kundër Khabib Nurmagomedovit në meçin "UFC 229" në Las Vegas, duke thënë se mezi pret të luftojë përsëri me rusin e pamposhtur. Nurmagomedovi e fitoi meçin, e prishur nga skena të shëmtuara pas përfundimit, duke e detyruar irlandezin të dorëzohet pasi e zaptoi në fytyrë në raundin e katërt. Meçi u prish nga përlëshja që rusi e shkaktoi pasi e kapërceu kafazin tetëkëndësh duke e sulmuar ekipin e McGregorit. Dy anë-



tarë të ekipit të Khabibit e sulmuar McGregorin në kafaz pas incidentit.

McGregor ka komentuar rreth meçit, duke shkruar: "Nokaut i mirë. Mezi e pres rimeçin". Se a do t'i plotësohet apo jo dëshira e irlan-

dezit është çështje tjetër megjithatë, pasi e ardhmja e Nurmagomedovit është në pikëpyetje serioze pas rolit të tij në skenat tronditëse që ndodhen pas fitores së tij. Presidenti i UFC-së, Dana White, ka lënë të hapur mundësinë që rusit t'i merret titulli i fituar mbrëmë në kategorinë e lehtë për shkak të përlëshjes që e shkaktoi. White refuzoi ta diskutojë mundësinë e rimeçit mes dyshes, duke thënë se priten masa nga autoritetet shtetërore të Nevadas pas incidentit.

SHKURT

Ajeti shënon në fitoren e Baselit

Albian Ajeti ka vazhduar të shënojë gola në kampionatin zviceran. Sulmuesi nga Kosova ka qenë edhe një herë vendimtar për skuadrën e vet, Baselit. Baseli ka marrë një fitore tejet të rëndësishme në udhëtim tek St Galleni, 1-3. Vendësit kaluan në epërsi në minutën e 31-të, por sulmuesi nga Kosova barazoi rezultatin në 1-1 gjashtë minuta më vonë. Albiani në këtë takim luajti për 73 minuta para se të zëvendësohej nga Oberlin. Në anën tjetër Taulant Xhaka ishte në bankën rezervë dhe u inkuadrua në lojë shtatë minuta para fundit të ndeshjes. Për Ajetin goli ndaj ish-skuadrës së tij St Gallen ishte i katërti në këtë kampionat derisa ka bërë edhe tre asistime.

Mourinho ofendon gazetarët

Manchester Unitedi nuk është aty ku duan tifozët, edhe pse fitoi kundër Newcastleit. Portugezin shumëkush pas 45 minutave të para e kanë menduar të shkarkuar, por në fund "Djajtë e Kuq" e përmbysën rezultatin nga 0-2 në 3-2. Pati edhe pak fat, pasi skuadra e Benitezit i kishte shanset ta mbyllte takimin. Gjithsesi fituesi nuk gjykohej dhe Murinjo jo vetëm që nuk do të gjykohej, por edhe kalon në sulm. "Shkofshi në të ëmës, bij k*****", ishin fjalët e shqiptuara nga trajneri portugez në gjuhën e tij. Nuk duroi më, ndërkohë që në konferencë u shpreh: "Jam 55-vjeçar dhe deri tani nuk kisha parë një gjueti të tillë shtrigash".

Ramosi kundër shkarkimit të trajnerit

Kapiteni Sergio Ramos e konsideron lëvizjen e fundit që duhet bërë një largim të mundshëm të trajnerit. Pas humbjes me Alaveshin, ai ka thënë se është shumë herët për vendime të tilla. "Më duket çmenduri dhe as nuk duhet ta mendojmë. Por ky nuk është një vendim në dorën e lojtarëve. Janë të tjerët që duhet të merren me këtë punë. Ne duhet ta bëjmë detyrën tonë dhe ta ndihmojmë skuadrën të marrë rezultatet", ka thënë Ramosi.

Marquezi triumfon edhe në Tajlandë

Marc Marquez fiton Çmimin e Madh të Tajlandës në Moto Gp dhe afrohet gjithnjë e më shumë me fitimin e titullit kampion në klasën mbretërore për herë të pestë në karrierë. Spanjollit i Hondas zyrtare fitoi një garë shumë të luftuar që pa si protagonistë kryesorë Marquezin dhe italianin e Ducatit Dovizioso i cili u dorëzua vetëm në fund. Në podium bashkë me Marquezin e Dovin u ngjit edhe Maverick Vinales me Yamahan i cili la pas shokun e skuadrës, Valentino Rossin. Pas këtij sukcesi Marquezi kryeson klasifikimin e përgjithshëm me 77 pikë avantazh nga ndjekësi më i afërt Dovizioso dhe mund të shpallet kampion që në Motegi të Japonisë.

Matthausi kritikon Bayernin

Bayerni luajti një ndeshje tmerrësisht zhgënjyese këtë të shtunë, duke u shpartalluar 3-0 në Mynih nga Borussia Monchengladbach, ndërsa ish-futbollistit legjendar Lothar Matthaus i mjaftoi të shihte vetëm një orë nga ndeshja, për të dhënë verdiktin e tij. Matthaus, tashmë komentator për "Sky", arriti në një konkluzion shkatërrimtar: "Përveç ndonjë topi të rastësishëm në zonë, Bayern krijoi shumë pak shanse për shënim dhe diçka e tillë është e pafalshme për një ekip me cilësinë e tyre". Problemi kryesor duket mungesa e një skuadre të vërtetë në fushë. "Nuk shoh ndonjë bashkëpunim në fushë", ka deklaruar Matthaus. Javët e fundit ka pasur zëra për probleme brenda ekipit, me James Rodriguezin që flitet se ka pasur debate me trajnerin Niko Kovaç, por ky i fundit ka përgënjeshtuar gjithçka, duke e quajtur "pozitive" atmosferën. Megjithatë, Matthaus ka dyshime në këtë pjesë: "Nëse shih ndeshjen e sotme dhe sjelljen e lojtarëve, asgjë nuk duket në rregull!"



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerziteteske Bolničke i Kliniçe Sluzbe Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Universitetski Klinicki Centar Kosova –
University Clinical Center of Kosovo
Sektori i Personelit



Nr.Ref. 1914/18, datë 05.10.2018.

Në bazë të nenit 13 pika 3 e Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, nenit 13 pika 1 e Statutit të QKUK-së, nenit 6 pika 5.1, të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, dhe Rekomandimit të Kryesuesit të Komisionit përzgjedhës të datës 03.10.2018, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së, nxori këtë:

V E N D I M

Për përsëritje të Konkursit publik,

- I. Konkursi publik nr. 1259, datë 11.09.2018 për pozitën **Zyrtar Ligjor në QKUK/SHSKUK**, vazhdohet edhe për dy javë nga dita e publikimit në njërin nga mjetet e informimit.
- II. Obligohet Sektori i Personelit për zbatimin e këtij Vendimi;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Komisioni përzgjedhës sipas Vendimit nr. 1259/2 datë 14.09.2018, pas shqyrtimit të të gjitha dosjeve, gjeti së konkurruan gjithsej 5 kandidatë për **Zyrtar Ligjor në QKUK/SHSKUK**, por në bazë të nenit 6 paragrafi 5.1 i Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nuk kishte kandidatë të mjaftueshem. Andaj, Komisioni përzgjedhës rekomandon që ky konkurs të vazhdohet edhe për 15 ditë tjera, me qellim t'ju jepet rasti edhe kandidatëve tjerë (aplikuesëve) që t'i plotësojnë kushtet dhe kriteret e këtij Konkursi.

Prandaj, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së, në bazë të kompetencave, konform ligjit në fuqi dhe njoftimit në ljalë lejon përsëritjen e Konkursit publik edhe për dy javë nga dita e publikimit në njërin nga mjetet e informimit.

Me sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

VENDIMI T'I DORËZOHET

- ✓ Zyrës së personelit,
- ✓ Një mediumit informativ.
- ✓ Arkivit.

Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së

Dr. Basri Sejdiu



SHOQATA E PRODHUESVE
TË QUMËSHIT TË KOSOVËS
KOSOVO ASSOCIATION OF
MILK PRODUCERS KAMP

KONKURS PËR VEND PUNE

Zyrtar për mostrim (marrjen e mostrave të qumështit) për nevojat e projektit "Transparenca dhe Neutraliteti"

Përgjegjësitë dhe detyrat kryesore:

- Organizon punën dhe është përgjegjës në marrjen e mostrave të qumështit sipas procedurave zyrtare;
- Organizon trajnime sipas kërkesës për fermerë në menaxhimin e fermës;
- Përgadit planin dhe raportin javor mujor të punës bazuar në obligimet dhe aktivitetet e punës;
- Raporton në mënyrë të rregullt tek kordinatori në lidhje me aktivitetet e planifikuara;
- Kryen edhe detyra tjera sipas rregullores se punës të cilat i cakton udhëheqësi drejtpërdrejt;

Aplikuesit duhet të kenë kualifikimet dhe aftësitë vijuese:

- Të jetë me përgatitje superiore-Fakulteti i Bujqësisë & Veterinarisë (drejtimi- Veterinari)
- Përvoja e punës - minimum 3 vite në profesion apo punë të natyrës së njejtë,
- Vertetim nga gjykata se aplikuesi nuk është nën hetime
- Aftësi të shkëlqyeshme të komunikimit; iniciativë dhe kreativitet;
- Leja e vozitjes e domosdoshme kategoria B. (minimum 3 vite përvojë)
- Shkathtësi kompjuterike në aplikim të programeve (Excel, Word, Power Point, Access)
- Njohja e gjuhës angleze e preferuar;

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin një biografi profesionale (CV) në formatin e EU <http://europass.cedefop.europa.eu/europass/home/hornav/Downloads/EuropassCV/CVTemplate.csp> dhe një letër motivuese. Dokumentet duhet dërguar në e-mailin: transparenca.neutraliteti@gmail.com

Vetëm kandidatët e përzgjedhur për listen e ngushtë do të kontaktohen. Data e fundit për pranimin e aplikacioneve është **12.10.2018**.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerziteteske Bolničke i Kliniçe Sluzbe Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Universitetski Klinicki Centar Kosova –
University Clinical Center of Kosovo
Sektori i Personelit



Nr.Ref. 1914/18, data 05.10.2018.

U skladu sa članom 13 stav 3 Statuta Kosovske Bolnice i Službe za Kliničku Bolnicu, članom 13 tačka 1 Statuta UKCK, članom 6 tačka 5.1, Administrativno uputstvo (MRSZ) br. 07/2017 o regulisanju postupaka konkursa u javnom sektoru, i Preporuka predsednik Komisije za izbor na dan 03.10.2018. godine, Generalni Direktor SHSKUK-a izdao je sledeće:

O D L U K A

Za ponavljanje javnog konkursa

I. Javni konkurs br. 1259, od 11.09.2018. Godine za poziciju **Pravni Služenik u UKCK/UBKSK**, produžava se dve nedelje od dana objavljivanja u jednom od sredstava informisanja.

III. Sektor kadrova je obavezan da izvrši ovu Odluku;

II. Ova odluka stupa na snagu danom potpisivanja.

O b r a z l o Ź e n j e

Komisija za izbor prema Odluci br. 1259/2 od 14.09.2018, nakon razmatranja svih dosijea, utvrdio da se kandiduje za ukupno 5 kandidata za **Pravni Služenik u UKCK/UBKSK**, ali prema članu 6 stav 5.1, Administrativnog Uputstva (MRSZ) br. 07/2017 o Regulisanju Postupaka Javnih Konkursa, nije bilo dovoljno kandidata. Zbog toga, Komisija za Izbor, preporučuje da se konkurs nastavi još 15 dana, kako bi se drugim kandidatima (aplikantima) pružila mogućnost da ispune uslove i kriterijume ovog konkursa.

Stoga, Generalni Direktor SHSKUK-a, u skladu sa nadležnostima, i sa važećim zakonom i konkretnim prigovorom dozvoljava ponavljanje javnog konkursa za dvije nedelje od dana objavljivanja u jednom od sredstava informisanja.

Kao što je već navedeno, odlučeno je kao u dispozitivu ove odluke.

ODLUKA KOJI SE PODNOSI

- * Kancelarija za kadrove,
- * Informacioni medij.
- * Arhiva.

Generalni Direktor UBKSK.

Dr. Basri Sejdiu

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania N.N.P. "Qendrimi - 5" Sh.p.k Sllovi, Lipjan, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për shfrytëzimin e rreshpeve sericitike, kuaco-sericitike, klorito-sericitike në lokalitetin Quka, Sllovi komuna e Lipjanit.


Njoftohet publiku i interesuar se më datën 01.11.2018. në ora 11:00 në hapësirat e Restorant "Te Gazi" fshati Sllovi komuna Lipjanit, do të organizohet debat publik nga Kompania N.N.P. "Qendrimi - 5" Sh.p.k Sllovi, Lipjan, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për shfrytëzimin e rreshpeve sericitike, kuaco-sericitike, klorito-sericitike në lokalitetin Quka, Sllovi komuna e Lipjanit.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Njoftim

Njoftojmë të interesuarit se me datën 15 Tetor 2018 (e hënë) me fillim në orën 12:00 Bsc. i dipl. Muhamed V. Maxhuni mbron punimin e Masterit me titull "Hulumtimi i disa parametereve në disa kultivarë të patates (*Solanum tuberosum* L.) në Pestovë të Vushtrrisë". Mbrojtja publike do të jetë në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë në Prishtinë.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte



OFERTË PËR SHITJE TË SHTËPISË

Shitet shtëpia dykatëshe, me sipërfaqe prej 218 m², dhe trualli me sipërfaqe prej 410 m².

Shtëpia gjendet në Prishtinë, në lagjen "Aktash I", rr. "Ferhat Draga" nr. 1.

Procedura e transaksionit nga shitësi te blerësi bëhet pas nënshkrimit të kontratës së shitblerjes dhe pagesës së çmimit të kontraktuar, pastaj paluejtshmëria e përshkruar më lart kalon te blerësi.

Çmimi sipas marrëveshjes.

Informata më të hollësishme mund të merren në numrin e telefonit 001-347-331-8305 në Nju Jork, kurse në Prishtinë në celularin 044-166-580.

AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperiencia jonë
- përfitimi i juaj.**

Ju mirëpret:

Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333



Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Ndërmarrje Publike Nr. 03/L-087, Kodit të Etikës dhe Qeverisja Korporative për Ndërmarrjet Publike dhe nenit 21.3.6 të Statutit të KRM "UNITETI"SHA-Mitrovicë, Bordi i Drejtorëve në takimin e rregullt me datë 06.10.2018, vendosi që me datë 08.10.2018 të shpallë këtë:

PLOTËSIM PËR K O N K U R S I N

I cili është shpallur me datën 05.10.2018

Pozita: Krye Shef Ekzekutiv
I përgjigjet: Bordit të Drejtorëve
Vendi: Mitrovicë

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Bordi i Drejtorëve dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të njohur të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, si dhe plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2 pikat (d), (f), (j), (k) dhe (l), nenit 17.3 pika (a), dhe (b), detyrimin të dhënies së deklaratës nën betim sipas nenit 17.5 të Ligjit për Ndërmarrje Publike dhe se kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë.

Lumë's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898
Sallon Depilimi Lumë's Details
lumessedetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Rizan Rizanaj shpall te pavlefshme dëftesat e vitit I,II,III, IV, SHMM "Luciano Motroni" Prizren.
- ▶ Përparim Fetah Jashari nga Babushi i Muhaxherëve të komunës së Lipjanit,shpallë të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Profesionale "Adem Gllavica" në Lipjan. Viti shkollor 2006-2007
- ▶ Dr. Luljeta Zaraj shpall të pavlefshme licencën e punës për doktor të mjekësisë së punës, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë.
- ▶ N.Sh. "CENTER RELAX-VIP", e cila gjendet në lagjen "Arbëria" në Prishtinë shpall të pavlefshme certifikatën dhe numrin fiskal: 600911880.
- ▶ N.H. "BUFFALO BACK PACKERS" SHPK, shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me numër të regjistrimit të biznesit: 70976838.
- ▶ AutoTaxi "Fejza Ahmeti" shpall të pavlefshme numrin e biznesi: 80335164, Vushtrri.
- ▶ Xhemaj Kadriu shpallë të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Adyl Frashëri" në Prishtinë viti 1993
- ▶ Bashkëpronarja Vesna Grujic shet pjesën e vetë ideale në parcelën kadastrale P-70202018-00001K-0 Zona Kadastrale Gojbulë Komuna e Zveçanit. Ftohen bashkëpronaret që nëse janë të interesuar për blerje të kësaj prone të lajmërohen te i autorizuari i saj Savic Dimitrije nga Zveçani.
- ▶ Urgjentisht kërkoj banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155
- ▶ Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.
- ▶ Urgjentisht kërkoj banesë me qira në Prishtinë, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155
- ▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.
- ▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.
- ▶ Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958
- ▶ Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.
- ▶ Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783
- ▶ Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)
- ▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- ▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- ▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.
- ▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.
- ▶ Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

Lëshoj shtëpinë me qira, e cila gjendet në lagjen e "Universiteti" përball rrugës B dhe përball marketit Viva Fresh Store. Shtëpia është 100 metra katror dhe e mobiluar. Është e përshtatshme për zyre dhe banim. Numri kontaktues 049-574-169.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

